

**POLITIKAT E PËRFSHIRJES
SOCIALE PËR FËMIJËT DHE
FINANCIMI I TYRE NË SHQIPËRI**

► Falënderime

Botimi “Politikat e përfshirjes sociale për fëmijët dhe financimi i tyre në Shqipëri” përbëhet nga tri pjesë, të cilat përmbajnë rezultatet e studimeve të veçanta, të ndërmarra nga tri institucione dhe të mbështetura financiarisht nga UNICEF-i.

Pjesa e parë i kushtohet analizës së politikave të përfshirjes sociale për fëmijët. Kjo pjesë është përgatitur nga ekspertët e Qendrës Shqiptare për Studime Ekonomike, të udhëhequr nga Dr. Zef Preçi dhe të përbërë nga Jonida Narazani, Valbona Jaupllari dhe Marsida Çela.

Pjesa e dytë i kushtohet analizës së kostove të politikave sociale për fëmijë. Kjo pjesë është përgatitur nga ekspertët e Forumi Shqiptar Social Ekonomik, të drejtuar nga Prof. Dr. Fatmir Memaj dhe të përbërë nga Kjudjan Seferaj dhe Albana Idërshaj.

Pjesa e tretë i kushtohet analizës së buxheteve vendore si mekanizëm i përfshirjes sociale të fëmijëve. Kjo pjesë është përgatitur nga specialistët e Institutit të Kërkimeve Urbane, të drejtuar nga Zana Vokopola dhe të përbërë nga Lindita Oshafi, Fabiola Zeqiri dhe Edlir Vokopola.

Së fundi, falënderime të veçanta për Jolanda Memaj, e cila mblodhi dhe përpunoi të gjithë informacionin, në përputhje me kërkesat e këtij botimi. Falënderime gjithashtu për mbështetjen e vlefshme të siguruar nga Arlinda Ymeraj, përgjegjëse për politikat sociale në UNICEF dhe Eliana Paravani, asistente programi për drejtimin dhe realizimin e projektit; Natasha Pepivani, Mimoza Gjika dhe Iain F. Wilson, për redaktimin, përkthimin, përshtatjen dhe përgatitjen e tekstit final të raportit në gjuhën shqipe dhe angleze.

Përmbajtja

► Përmbajtja

Përmbledhje

PJESA E PARË: POLITIKAT E PËRFSHIRJES SOCIALE PËR FËMIJËT

- 1. Politikat që garantojnë të drejtën e mbijetesës dhe zhvillimit**
 - 1.1 E drejta për arsim**
 - 1.2 E drejta e mbijetesës dhe e përfitimit të shërbimeve shëndetësore**
- 2. Politikat që garantojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të përfshirjes për grupet e përjashtuara**
 - 1.1 E drejta e mbrojtjes së fëmijëve/ të rinjve, jashtë kujdesit prindëror**
 - 1.2 E drejta e mbrojtjes nga dhuna (në familje apo komunitet)**
 - 1.3 E drejta e mbrojtjes ndaj punësimit të fëmijëve**
 - 1.4 E drejta e mbrojtjes së fëmijëve në konflikt me ligjin apo në gjakmarrje**
- 3. Politikat që garantojnë të drejtën e fëmijëve për të mos u diskriminuar**
 - 1.1 E drejta e fëmijëve të komunitetit rom për t'u mbrojtur nga diskriminimi**
 - 1.2 E drejta e fëmijëve me aftësi të kufizuar për t'u mbrojtur nga diskriminimi**
- 4. Politikat që garantojnë të drejtën e fëmijëve për të përfituar shërbime bazë**
 - 1.1 Vlerësim i mundësive për shërbime bazë të fëmijëve, familjeve dhe komuniteteve**
 - 1.2 Aksesit në arsimin e detyruar**
 - 1.3 Aksesit në shërbime shoqërore**
 - 1.4 Aksesit në shërbimet shëndetësore**
 - 1.5 Krijimi i kapaciteteve njerëzore për trajtimin e dhunës në familje**
 - 1.6 Identifikimi i problemeve që lidhen me mundësinë e përdorimit të shërbimeve të domosdoshme shoqërore**

PJESA E DYTË: KOSTOT E POLITIKAVE SOCIALE PËR FËMIJËT

- 1. Situata makroekonomike dhe buxhetore për vitin 2009**
- 2. Shpenzimet buxhetore për fëmijët**
- 3. Financimi i politikave sociale – ecuria në vite**
 - 3.1 Shpenzimet për Arsimin**
 - 3.2 Shpenzimet për mbrojtjen sociale**
- 4. Politikat dhe strategjitë për mbrojtjen sociale në Shqipëri dhe financimi i tyre**
 - 4.1 Buxhetimi i politikave sociale**

1. Decentralizimi
 - 1.1 Koncepte dhe përkufizime
 - 1.2 Kategoritë e decentralizimit dhe qeverisja vendore
 - 1.2.1. *Decentralizimi politik*
 - 1.2.2. *Decentralizimi administrativ*
 - 1.2.3. *Decentralizimi fiskal*
 - 1.3 Shqipëria dhe procesi i decentralizimit
 - 1.4 Ndarja territoriale e Shqipërisë
 - 1.4.1 *Vlerësim i përgjithshëm i ndarjes rajonale*
2. Funkcionet e pushtetit vendor
 - 2.1. Analiza dhe vëzhgime
 - 2.2. Shpërndarja e fondeve nëpër rajone – zhvillimet e fundit
 - 2.3. Analizë cilësore dhe sasiore për rajonet specifike
 - 2.3.1. Rajoni i Kukësit
 - 2.3.2. Rajoni i Elbasanit
3. Funkcionet sipas fushave të interesit – niveli rajonal
 - 3.1. Arsimi parauniversitar
 - 3.2. Kujdesi shëndetësor parësor dhe kujdesi shëndetësor publik
 - 3.3. Kujdesi social dhe reduktimi i varfërisë
4. Strukturat përgjegjëse
 - 4.1 Shpërndarja e buxhetit në bashkitë
 - 4.2 Funkcionet e përbashkëta
 - 4.2.1 *Arsimi – Vrojtim*
 - 4.2.2 *Shëndetësia – Vrojtim*
 - 4.2.3 *Ndihma sociale – Vrojtim*
 - 4.3 *Strukturat ligjore për fëmijët dhe sektorët përkatës*
 - 4.3.1 *Arsimi*
 - 4.3.2 *Ndihma shoqërore*
 - 4.4 Vlerësimi i bashkive nën drejtimin e përbashkët lidhur me shpërndarjen e buxhetit për fëmijët dhe sigurimin e shërbimeve
 - 4.5 Vrojtimi i përbashkët për dy bashki
 - 4.5.1 *Arsimimi*
 - 4.5.2 *Shëndetësia*
 - 4.5.3 *Ndihma dhe mbrojtja shoqërore*

Vlerësime përfundimtare
Rekomandime

Shtojca
Bibliografi

► Përmbledhje

Punimi “**Politikat e përfshirjes sociale për fëmijët dhe financimi i tyre në Shqipëri**”, është një përmbledhje e përpunuar e tri studimeve:

(i) “Mbi zbatimin e Strategjisë së Përfshirjes Sociale 2008-2009”, kundrejt respektimit të të drejtave të fëmijëve”, përgatitur nga Qendra Shqiptare për Studime Ekonomike (ACER);(ii) “Kostoja e Politikave të Përfshirjes Sociale”, përgatitur nga e Forumi Shqiptar Social Ekonomik (ASET-i), dhe (iii) “Analiza e buxhetit dhe rishikimi i shpenzimeve publike me një vështrim specifik në analizën e impaktit të decentralizimit financiar në buxhetin e fëmijëve”, përgatitur nga Instituti i Kërkimeve Urbane”(URI), të mbështetura financiarisht nga UNICEF-i gjatë vitit 2010.

Punimi “**Politikat e përfshirjes sociale për fëmijët dhe financimi i tyre në Shqipëri**”, i paraqitur këtu, ka për qëllim që të tërheqë vëmendjen e lexuesve dhe studiuesve mbi politikat e përfshirjes sociale të fëmijëve, të cilat zbatohen sot në Shqipëri, të shoqëruara nga analiza e buxheteve përkatëse, në nivelin qendror të qeverisjes, si edhe në nivelin vendor. Informacioni që sjell analiza shumëplanëshe politike, ekonomike dhe sociale, shërben për të formuluar konkluzione të rëndësishme për domosdoshmërinë e rishikimit të politikave institucionale dhe buxhetore, me qëllim rritjen e efektivitetit të programeve të mbrojtjes sociale dhe realizimin më të mirë të të drejtave të fëmijëve.

Gjatë 14-viteve të fundit, ndryshimet politike dhe socio-ekonomike në Shqipëri kanë rritur problematikën e fëmijëve duke i ekspozuar ata ndaj dhunës, shfrytëzimit, abuzimit dhe braktisjes. Zhvendosjet drastike demografike kanë dobësuar rrjetet tradicionale të mbrojtjes komunitare dhe kanë kufizuar mundësitë e familjeve për të përdorur shërbime cilësore sociale, duke rritur rrezikun e përjashtimit socio-ekonomik. Për rrjedhojë, një pjesë e fëmijëve janë të përjashtuar ose në rrezik përjashtimi e, për pasojë, kanë nevojë për mbrojtje të veçantë shoqërore.

Mbrojtja dhe sigurimi i të drejtave të fëmijëve duhet të përbëjë një përparësi të punës së pushtetit qendror e vendor. Detyrimet që lindin nga zbatimi i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, e ratifikuar nga Shqipëria në 1992¹ (në vijim KDF), duhet të zbatohen dhe reflektohen në të gjitha vendimet të cilat prekin interesat e fëmijëve. Decentralizimi i shërbimeve sociale² në Shqipëri sjell detyrime për pushtetin vendor që të hartojë politika të qarta me fokus fëmijët. Përbushja e detyrimeve që dalin nga Objektivat e Mijëvjeçarit, realizohen nëpërmjet zbatimit të tyre në nivel qendror e vendor.

1 Ratifikuar me ligjin nr. 7531 datë 11.12.1991 “Për ratifikimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijëve”,

2 Ligji nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për qeverisjen vendore”, si dhe ligji nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore”

Me gjithë përpjekjet në rritje, në Shqipëri ende nuk ka një sistem gjithëpërfshirës të mbrojtjes së fëmijëve. Strukturat ekzistuese për mbrojtjen e tyre janë të kufizuara dhe të fragmentuara dhe mekanizmat e koordinuar për identifikimin, vlerësimin, rekomandimin dhe pajisjen me shërbimet e duhura për mbështetje, janë të papërshtatshëm. Ekspertiza teknike është e kufizuar, në aspektin e sigurimit të shërbimeve të specializuara, si dhe të mekanizmave institucionalë, planifikimit dhe menaxhimit në nivelet rajonale dhe vendore.

Punimi **“Politikat e përfshirjes sociale për fëmijët dhe financimi i tyre në Shqipëri”**, ashtu si edhe u sqarua më lart, përbëhet nga tri pjesë. *Pjesa e parë*, e titulluar **”Politikat e përfshirjes sociale për fëmijë”**, paraqit dhe analizon politikat kryesore të përfshirjes sociale, nën këndvështrimin e të drejtave të fëmijëve, përkatësisht: të drejtës për mbijetesë dhe zhvillim, të drejtës për mbrojtje, të drejtës për mosdiskriminim, si edhe të drejtës për shërbime sociale themelore.

Pjesa e dytë, e titulluar **“Kostoja e politikave sociale për fëmijë”**, analizon shpenzimet publike, veçanërisht për zbatimin e politikave gjithëpërfshirëse për fëmijë. Informacioni i paraqitur në këtë pjesë ndihmon në formulimin e konkluzioneve mbi efektivitetin e buxhetit publik për sa u përket të drejtave dhe nevojave të fëmijëve. Gjithashtu, ky informacion mundëson rishikimin e shpërndarjes së buxheteve për politikat sociale të përfshirjes së fëmijëve.

Pjesa e tretë, e titulluar **“Buxhetet vendore – mekanizëm për realizimin e përfshirjes sociale të fëmijëve”**, trajton mundësitë reale të buxheteve vendore për hartimin dhe zbatimin e politikave të përfshirjes sociale, edhe në kushtet e decentralizimit të pushtetit vendor. Shpenzimet publike në nivel vendor analizohen në thellësi në këtë raport. Vlerësimi i të ardhurave të vetë bashkive dhe të ardhurave përkatëse nga buxheti qendror, vihen përballë politikave ekzistuese të përfshirjes sociale për të treguar drejtimit e zhvillimit të atyre reformave institucionale, që garantojnë zbatimin më të mirë të të drejtave të fëmijëve.

Të drejtat e fëmijëve në Shqipëri, pas ratifikimit të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, po bëhen gjithnjë e më shumë pjesë e agjendës të zhvillimit të politikave kombëtare dhe kuadrit ligjor e institucional. Këto reforma nuk do të kishin kuptim në rast se nuk do të reflektoheshin në nivel gjithëpërfshirës, me qëllim ndërmarrjen e nismave për të minimizuar problematikat që prekin sot fëmijët.

Strategjia Ndërsektoriale e Përfshirjes Sociale, është një komponent i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI). Kjo strategji e ka burimin nga strategjitë e Mbrojtjes Sociale, Punësimit, Arsimit, Shëndetësisë, Transportit, Furnizimit me Ujë, Planifikimit Urban dhe Drejtësisë, të cilat janë miratuar ose janë në proces formulimi. Ajo duhet parë në lidhje me Strategjitë Ndërsektoriale të Zhvillimit Rural, kundër Krimin të Organizuar, Terrorizmit dhe Trafikimit, të Barazisë Gjinore dhe Dhunës në Familje, të Rinisë, Informacionit dhe Teknologjisë së Komunikacionit dhe asaj të Decentralizimit. Në këtë strategji një vëmendje e veçantë u është kushtuar çështjeve të fëmijëve, veçanërisht kategorive të fëmijëve që janë më vulnerabel e që përbëjnë rrezik përjashtimi social.

Duke e parë SNPS-në nën këndvështrimin e të drejtave të fëmijëve, synohet të paraqitet një kornizë e zbatimit të saj aktual. Nëpërmjet monitorimit të indikatorëve specifikë të parashikuar që nga koha e miratimit të strategjisë, ky raport do të shërbejë si mjet për përmirësimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të politikave të përfshirjes sociale. Në saje të kësaj ecurie do të paraqiten edhe disa konsiderata dhe rekomandime, të cilat do t'i vijnë në ndihmë zbatimit të mëtejshëm të Strategjisë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Analiza e përshkruese dhe bashkërenduese e të dhënave është realizuar nën këndvështrimin e të drejtave sipas fushave mbi të cilat janë grupuar dhe treguesit:

Mbijetesat dhe zhvillimi

- E drejta për arsimim
- Mbijetesat dhe aksesit në shërbime shëndetësore

Mbrojtja

- Mbrojtja për të jetuar në familje apo në struktura të përshtatshme, kur ky kujdes mungon
- Mbrojtja ndaj dhunës (në familje apo në komunitet)
- Mbrojtja ndaj punësimit të fëmijëve
- Mbrojtja e fëmijëve në konflikt me ligjin apo në gjakmarrje

Mosdiskriminimi

- Fëmijët me aftësi të kufizuara
- Fëmijët romë

Aksesit ndaj shërbimeve sociale bazë

- Vlerësimi i aksesit të fëmijëve, familjeve dhe komuniteteve ndaj shërbimeve bazë,
- Identifikimi i problemeve që lidhen me aksesin ndaj këtyre shërbimeve

1. Politikat që garantojnë të drejtën e mbijetesës dhe zhvillimit

1.1 E drejta për arsim

E drejta për arsimim përbën një parim të sanksionuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e cila garanton barazi para ligjit dhe liri nga diskriminimi për shkak të racës, gjinisë, etnisë dhe gjuhës. Të gjitha çështjet që lidhen me realizimin e këtij parimi të rëndësishëm janë në përputhje me KDF-në³ dhe aktet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria në kuadër të një arsimit cilësor e gjithëpërfshirës. Shteti shqiptar ka ratifikuar Protokollin Alternativ të Konventës së Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen e Fëmijëve në Konflike të Armatosura, në dhjetor 2008 dhe Konventën e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve ndaj Shfrytëzimit dhe Abuzimit seksual, në prill 2009. Gjithashtu, është ngritur grupi i punës dhe është në proces ratifikimi Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar. Mbetet për t'u ratifikuar Karta Evropiane e Gjuhëve Rajonale dhe Minoriteteve.

Në Strategjinë Ndërsektoriale të Përfshirjes Sociale, synohet që të gjithë fëmijët të marrin arsimin parashkollor. Janë marrë masat e mëtejshme për rritjen e përqindjes së regjistrimit në arsimin bazë, sidomos të fëmijëve të zonave rurale, e në veçanti të vajzave, duke përmblusur në këtë mënyrë një përparësi të Objektivave Zhvillimorë të Mijëvjeçarit të OKB-së dhe Partneritetit Evropian. Një strategji e veçantë për sistemin e arsimit parashkollor u përgatit nga MASH-i, e njohur si Strategjia Kombëtare për Sistemin Parashkollor 2004-2015⁴. Në të synohet zgjerimi dhe ofrimi i arsimit parashkollor jo vetëm që nëpërmjet tij të rritet aftësia e fëmijëve për shkollë, por edhe për t'u ofruar shërbime fëmijëve të vegjël të grupeve të prekshme, sidomos (por jo vetëm) në Shqipërinë Verilindore dhe për romët. Zhvillimi në fëmijërinë e hershme dhe ndërhyrja për fëmijët e rrezikuar, janë elemente të rëndësishme për arritjen e rezultateve në arsim.⁵

Në plotësim të kuadrit të politikave dhe iniciativave të ndërmarra në fushën e zhvillimit të arsimit, është miratuar së fundmi Strategjia Kombëtare për Arsimin Parauniversitar SKAP (2009 – 2013)⁶, e cila përfshin arsimin parashkollor, arsimin parësor dhe dytësor, arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe arsimin profesional. Ky dokument është në përputhshmëri me prirjet kryesore të zhvillimit të arsimit në Evropë dhe në botë dhe ka si qëllim të orientojë zhvillimin e arsimit parauniversitar. Sipas SKAP 2009 – 2013, regjistrimi në arsimin parauniversitar paraqitet me ulje në shifra absolute të numrit të nxënësve, si rezultat i uljes së numrit të lindjeve, si dhe rritje të përqindjes së pjesëmarrjes në nivelet më të larta si pasojë e politikave favorizuese të ndjekura nga qeveria. Politikat publike për ruajtjen dhe përmirësimin e mundësisë së përdorimit të arsimit, sidomos të arsimit fillor, marrin rëndësi vendimtare për rritjen ekonomike të Shqipërisë dhe për përpjekjet për zbutjen e varfërisë.

3 Referuar Neneve 28, 29 të KDF-së

4 Ky dokument u miratua në vitin 2006

5 Strategjia Ndërsektoriale e Përfshirjes Sociale 2007-2013, miratuar me VKM në 2 Shkurt 2008

6 Miratuar në Korrik 2009

Tabela 1:
Të dhëna statistikore për Arsimin (2007 - 2008) në vendet e rajonit dhe të BE-së

Treguesi	Shqipëria	Evropa	Serbia	Maqedonia	Kroacia	Slllovenia
Mesatarja e viteve të shkollimit	11,9	17,4	13	12	15	16,2
Përqindja e regjistrimit neto						
Parashkollor	50	75	45	29	45	75
Shkolla bazë e detyruar	92	95	96	93	90	93
Shkolla e mesme	57	85	82	80	84	91
Shkollat e mesme profesionale	19	62,7	70	65	70	

Burimi: MASH, SKAP 2009-2013, (2009)

Tabela 2:
Numri i fëmijëve që ndjekin Arsimin Parashkollor i shprehur në përqindje sipas shpërndarjes demografike e gjinisë⁷

Treguesit	2006-2007	2007-2008	2008-2009
Totali Neto	47,5	49,5	50,1
Zonat rurale	47,9	49,3	49
Zonat urbane	52,1	50,7	51
Femra	47,6	47,8	47,3
Meshkuj	52,3	52,2	52,7

Burimi: Të dhëna statistikore të marra nga INSTAT

Disa masa të marra nga MASH-i për të mbështetur fëmijët në nevojë u adresohen shumë pak nxënësve dhe ndoshta nuk janë atraktive.

Tabela 3:
Masat e MASH-it për mbështetjen e fëmijëve të rrezikuar

1. Udhëzime dhe Urdhra të posaçëm për shkollat kundër analfabetizimit
2. Grupe pune për identifikimin e situatës dhe marrjen e masave për të luftuar analfabetizimin
3. Arsimimi i fëmijëve të izoluar për shkak të fenomenit të gjakmarrjes; Udhëzime mbi arsimimin e fëmijëve që kanë braktisur shkollën për shkak të gjakmarrjes
4. Shpërndarje falas e librave për jetimët, paraplegjikët dhe tetrapejikët; fëmijët e familjeve që janë pjesë e skemës së ndihmës ekonomike paguajnë vetëm 10% të çmimit të librit
5. Zbatimi i projektit “Shansi i Dytë”

Problem përbëjnë fëmijët e familjeve me të ardhura të pakta, të zonave të thella malore, vajzat në zonat me mentalitet të prapambetur dhe me probleme të tjera sociale. Problematikat e kategorive të lartpërmendura ndikojnë në rritjen e nivelit të braktisjes së shkollës. Duke iu referuar statistikave, rezulton se ndër fëmijët që regjistrohen në arsimin e detyruar, numri i vajzave që braktisin shkollën është më i lartë. Deri tani, nuk kanë munguar politikat dhe projektet e hartuara dhe miratuara nga MASH-i, të cilat kanë synuar ndërhyrjen në zgjidhjen e problematikës së braktisjes së shkollës nga fëmijët.

Gjithashtu duhet të theksojmë se modelet pozitive të iniciuara nga MASH-i, të tilla si projektet “Shansi i Dytë” dhe “Braktisja e Fshehtë” kanë treguar rrugë të mundshme për sukses. Programi “Braktisja e Fshehtë”, i zbatuar nga MASH-i në nivel vendor dhe kombëtar, duke trajtuar të gjitha mangësitë e praktikave të mësimdhënies në klasa, është një shembull i modeleve pozitive që i nevojiten arsimit shqiptar sot. Sigurisht, të dyja këto modele janë një hap përpara në krahasim

7 Të dhëna statistikore të marra nga INSTAT

me praktikën e vendosjes së gjobave për fëmijët që braktisin shkollën, praktikë kjo që në fakt ka qenë e pazbatueshme për shkak të pengesave të mbledhjes së gjobave.⁸

1.2 E drejta e mbijetesës dhe e përfitimit të shërbimeve shëndetësore

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përcakton se shtetasit gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtën për kujdes shëndetësor nga shteti dhe kushdo ka të drejtë për sigurim shëndetësor sipas procedurës së caktuar me ligj⁹. Ky dokument e ngarkon shtetin me detyrën që të garantojë barazi në mundësinë e përdorimit të kujdesit shëndetësor dhe që të sigurojë mbrojtjen financiare nga problemet shëndetësore. Ky angazhim kushtetues mbështetet edhe nga KDF¹⁰ nëpërmjet parimeve për shërbime cilësore dhe gjithëpërfshirëse shëndetësore.

Këto parime rrjedhin nga parimet e përgjithshme të të drejtave të njeriut, si mbrojtja e lirisë, dinjitetit dhe siguria e çdo individi. që janë parimet bazë ligjore ku mbështetet dhe ofrimi i shërbimeve shëndetësore. Ato gjenden jo vetëm në ligjin “Për shëndetin riprodhues”, por edhe në ligjin “Për shëndetin” në përgjithësi.

Një sërë ligjesh që veprojnë drejtpërsëdrejti apo tërthorazi, mbështesin dhe sigurojnë të drejtën e fëmijës për shërbime shëndetësore. Treguesit e shëndetësisë për konsultoret e fëmijëve tregojnë një rritje të numrit të konsultoreve dhe vizitave në zonat rurale. Megjithatë, të dhëna të MSHP, tregojnë se vetëm 70% e fshatrave janë të mbuluara me ambulanca. Reduktimi i shërbimeve falas ka ndikuar ndjeshëm në shëndetin e fëmijëve të familjeve të varfra.

Tabela 4:

Tregues të Shëndetësisë - Konsultori i Fëmijës

Konsultori i fëmijës	2005	2006	2007	2008
Konsultore të fëmijës	1 845	1 891	1 946	2 010
Qytet	134	134	163	147
Fshat	1 711	1 757	1 783	1 863
Vizita në konsultore (000)	850	770	805	907
Vizita në fshat (000)	552	464	505	492

Burimi: INSTAT, “Shqipëria në Shifra 2009”

8 QFS, Fëmijët në Shqipëri, (2008)

9 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, 1998, Neni 55.

10 Referuar Konventa për të drejtat e Fëmijëve, Neni 24

2. Politikat që garantojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të përfshirjes për grupet e përjashtuara

Mbrojtja e fëmijës nuk konsiderohet vetëm si një veprim parandalues, por si një veprim që përqendrohet gjithashtu në ofrimin e shërbimeve deri në momentin që fëmija nuk është më në rrezik.

Qeveria shqiptare, e mbështetur edhe nga organizatat ndërkombëtare, si Banka Botërore etj., ka hartuar Strategjinë e Shërbimeve Shoqërore (2005-2010)¹¹. Objektivi i Strategjisë së Shërbimeve Shoqërore është reformimi i sistemit të përkujdesit shoqëror, për të siguruar të drejtat e fëmijëve, barazinë e mundësive dhe trajtime të barabarta në shërbimet shoqërore për fëmijët në nevojë.

2.1 E drejta e mbrojtjes së fëmijëve/ të rinjve, jashtë kujdesit prindëror

Shërbimet shoqërore për të rinj pa kujdes prindëror janë pjesë e programit për reduktimin e varfërisë dhe programit për kujdesin shoqëror. Legjislacioni, i cili mundëson zbatimin e programeve të sipërpërmendura, është ndërtuar në përputhje me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Qeveria shqiptare si edhe nga Konventa për të Drejtat e Fëmijëve. Ndonëse në funksion të mirëqenies dhe mbrojtjes së fëmijëve ekziston një kuadër ligjor e institucional i mirë, ai ende ka nevojë për përmirësim në drejtim të fokusimit ndaj të rinjve pa kujdes prindëror, e veçanërisht ndaj atyre që largohen nga përkujdesi, duke adresuar sfidat me të cilat ata përballen në këtë fazë të jetës, gjatë moshës 14-18 vjeç dhe pas moshës 18 vjeç.

Nuk ka një sistem ligjor të mjaftueshëm që mbulon nevojat e të rinjve që janë në përkujdesje apo që po dalin nga përkujdesja, veçanërisht atyre që largohen shumë herët. Fëmijët pa kujdes prindëror nuk janë konsideruar me përparësi në sistemin aktual të mbrojtjes shoqërore. Jo vetëm që nuk ka koordinim midis strukturave, por gjithashtu nuk ka planifikim të mirë të buxhetit për të këtë grup.

Shërbimet mbështetëse pas daljes nga përkujdesja janë të varfra dhe kanë dështuar për të siguruar nevojat e të rinjve, veçanërisht për punësimin dhe strehimin. Nuk ka shërbime publike të ofruara për këta të rinj dhe organizatat që ofrojnë shërbime kanë mungesë burimesh. Mungesa e shërbimeve dhe moskoordinimi i tyre nuk adreson mjaftueshëm nevojat e të rinjve. Nivelet e ulëta të arsimimit të tyre ndikojnë negativisht në mundësitë e tyre për punësim.

Fëmijët me histori përkujdesjeje vuajnë nga stigma dhe diskriminimi nga shoqëria shqiptare. Edhe fëmijët të cilët janë në përkujdesje, vuajnë nga stigma sociale dhe diskriminimi duke humbur kështu mbështetjen e shoqërisë. Ka një mungesë informacioni dhe ndërgjegjësimi publik për sa u përket çështjeve me të cilat këta të rinj përballen. Indiferenca e komunitetit dhe niveli i ulët i besimit nga ana e të rriturve, sjell predispozicionin që të rinjtë të përjetojnë më shumë dhunë dhe abuzim. Fëmijët e etnisë rome vuajnë në mënyrë të veçantë disavantazhe dhe përjashtim.

11 Në Prill 2005 u miratua me VKM-në nr.265, 28.04.2005, Strategjia e Shërbimeve Shoqërore (2005-2010).

2.2 E drejta e mbrojtjes nga dhuna (në familje apo komunitet)

Sipas Nenit 19 të KDF-së, fëmija gëzon të drejtën për t'u mbrojtur nga çdo lloj dhune. Kodi i Familjes parashikon humbjen dhe heqjen e përgjegjësisë prindërore në rastet kur prindërit kryejnë vepra penale ndaj fëmijëve të tyre apo kur i marrin ata si bashkëpunëtorë në kryerjen e një vepre penale. Rastet e heqjes së përgjegjësisë prindërore dhe marrja e masave urgjente në funksion të mbrojtjes dhe interesit më të lartë të fëmijës, dëshmon për një përmbushje të mirë të standardeve që garanton neni 19 i KDF-së.

Fenomeni i dhunës ndaj fëmijëve është sa i përhapur, aq edhe i fshehtë. Ndaj këtij fenomeni ka ndjeshmëri në opinion, gjithashtu punojnë edhe disa OJF të fushës së mbrojtjes të të drejtave të fëmijëve. Dhuna ndaj fëmijëve lidhet me mentalitetin e familjes shqiptare, e cila si një nga format e edukimit të fëmijës përdor edhe ndëshkimin. Ky mentalitet, ndonëse po tronditet, ende ekziston.

Dhuna në familje është ende e ndjeshme, por nuk ka të dhëna për shtrirjen, format dhe ndikimet e saj te fëmijët, kjo edhe për shkak të mentalitetit “për të mos nxjerrë problemet jashtë shtëpisë”. Është ende zotëruar koncepti se dhunimi fizik i fëmijëve është e drejtë e prindit. Nuk ka mekanizma që e përballin këtë dukuri.

Ligji “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” përcakton fëmijët si kategori me vëmendje te veçante. Ky ligj, parashikon ndjekje të programeve rehabilituese për të paditurin, por has probleme në zbatim duke qenë se mungojnë qendra të specializuara që mund të sigurojnë pritjen e viktimave në kushtet e emergjencës.

Ligji “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, nuk ka si qëllim të vetin sigurimin e shërbimeve për trajtimin e fëmijëve, viktima të dhunës, dhe nuk parashikon sistemin e referimit për fëmijët e dhunuar.

Strategjitë në mbështetje të fëmijëve si “*Strategjia kombëtare për fëmijët*” dhe “Plani i kombëtar i veprimit”, kanë adresuar mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna në familje, në shkollë dhe në komunitet; mbrojtjen nga abuzimi dhe neglizhimi (përjashtimi social i fëmijëve); mbrojtjen nga të gjitha format e shfrytëzimit dhe kanë parashikuar një seksion të veçantë për mbrojtjen e fëmijëve vajza, megjithatë këto parashikime ende nuk kanë gjetur zbatim.

“Strategjia kombëtare e luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, 2008-2010”, dhe dokumenti plotësues “*Strategjia kombëtare për luftën kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve, viktima të trafikimit*” gjithashtu ka prekur fenomenin e trafikimit, shfrytëzimit dhe abuzimit seksual, por mbetet i mangët ndërgjegjësimi për të gjitha formave të shfrytëzimit dhe abuzimit seksual, duke vënë theksin edhe tek të miturit meshkuj, si dhe bërjen e tyre pjesë të kurrikulave shkollore.

Lidhur me ndërgjegjësimin dhe edukimin e fëmijëve/ të rinjve në të gjitha institucionet arsimore, Instituti i Kurrikulës dhe Trajnimit ka ngritur grupet e hartimit të kurrikulës për arsimin bazë, si dhe është në proces vlerësimi i atyre ekzistuese dhe hartimi i kurrikulave të reja . Në kuadër të zbatimit të moduleve të ndryshme në orët e lira, në arsimin bazë, shkollat janë orientuar të trajtojnë edhe probleme të dhunës ndaj fëmijëve.

Në nivel DRA, ZA, shkolle, në zbatim të Rregullores së Ministrisë Nr. 8373, datë 26.11.2006, në planet vjetore, mujore, planifikohen dhe zbatohen veprimtari që trajtojnë probleme të dhunës në familje, shkollë e komunitet.

Nxjerrja e ligjit “Për mbrojtjen nga dhuna në familje” ka rritur shumë numrin e rasteve të raportimit të dhunës kryesisht nga nënat, ku fëmijët janë dëshmitarë të kësaj dhune dhe si të tillë janë edhe vetë të dhunuar. Ajo që vërehet është rritja nga viti në vit e numrit të denoncimeve. Kështu për 9-mujorin e parë të 2009, nga ana e strukturave të Policisë së Shtetit janë trajtuar gjithsej 915 raste të dhunës në familje, prej të cilave 640 janë trajtuar me kërkesë-padi “Për lëshimin e Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes” ose “Urdhrit të Mbrojtjes”. Nga të gjitha strukturat vendore të policisë ka vijuar me sukses plotësimi i kërkesë-padive “Për lëshimin e Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes/ Urdhrit të Mbrojtjes” dhe, pothuajse në të gjitha rastet, viktimave u është garantuar mbrojtja e nevojshme. Gjatë periudhës janar – prill 2009, janë ofruar 370 këshillime ligjore dhe 395 këshillime psikosociale. Nga gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, janë lëshuar 8 “Urdhra Mbrojtje/ Urdhra të Menjëhershëm Mbrojtjeje”. Janë përgatitur 33 akte për rastet e grave ose vajzave të mbështetura me asistencë ligjore dhe mbështetje psikosociale falas.

2.3 E drejta e mbrojtjes ndaj punësimit të fëmijëve

E drejta e fëmijëve për të qenë të mbrojtur nga shfrytëzimi dhe përdorimi për punë garantohet nga Kushtetuta e Shqipërisë. “Strategjia kombëtare për fëmijët” dhe “Plani kombëtar i veprimit”, si dhe “Strategjia kombëtare kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjes së fëmijëve viktime të trafikimit” parashikojnë mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi. Detyrimi i fëmijëve për të punuar, për të siguruar të ardhura, për të lypur apo për të kryer veprime që dëmtojnë zhvillimin e tyre, përbën veprë penale, ndonëse nuk parashikohen sanksione ndaj personave që punësojnë fëmijë në mënyrë të kundërligjshme. Punësimi i fëmijëve ndalohet për sa kohë fëmijët ndjekin arsimin e detyruar¹².

Me gjithë penalizimet ligjore, fenomeni i punësimit të fëmijëve në Shqipëri është mjaft i përhapur. Sipas fushatës së BKTF në 2007 “Kundër Lypjes së Fëmijëve”, në Shqipëri janë 6700 fëmijë të punësuar dhe fëmijë të rrugës. 61% e fëmijëve të rrugës në rrethin e Tiranës, bëjnë punë të ndryshme, si mbledhja e sendeve dhe larja e makinave. Ndër format më të rënda të shfrytëzimit të fëmijëve, evidentohet lypja, duke u detyruar prej prindërve për shkak të varfërisë ekstreme në të cilën jeton familja. Fëmijët, shpesh lypin deri në 12 orë në ditë në sheshet dhe rrugët kryesore të Tiranës apo të qyteteve të tjera të Shqipërisë, madje dhe deri në orët e vona të natës duke dëmtuar kështu shëndetin e tyre. Fëmijët e rrugës, janë të ekspozuar për më tepër ndaj të gjitha formave të dhunës gjatë kohës që ata qëndrojnë në rrugë. Këta fëmijë, nuk e frekuentojnë shkollën.

2.4 E drejta e mbrojtjes së fëmijëve në konflikt me ligjin apo në gjakmarrje

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përmban parime të rëndësishme lidhur me liritë dhe të drejtat e fëmijëve. Kështu, në Kushtetutë (*neni 27*) sanksionohet se: liria e të miturit mund

12 Neni 60 i ligjit nr. 7952, datë 21.06.1995, “Për sistemin arsimor parauniversitar”.

të kufizohet në rast se ka nevojë për mbikëqyrje, për qëllime edukimi ose për t'u shoqëruar në organin kompetent; (*neni 30*): kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë; (*neni 25*): Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose degradues; (*nenin 54*): fëmijët gëzojnë një mbrojtje të veçantë nga shteti dhe në kuadër të lirive dhe të drejtave të njeriut; (*neni 42*): liria dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj, nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj etj.

Kodi Penal është një dokument themelor që rregullon kuadrin institucional, mbi të cilin zbatohet e drejta e mbrojtjes së fëmijëve në konflikt me ligjin. Ndaj të miturit nuk mund të zbatohet dënimi me burgim të përjetshëm (*neni 31* i Kodit Penal); dënimi me burgim i të miturit nuk mund të jetë më shumë se gjysma e dënimit që parashikon ligji për veprën penale të kryer (*neni 51* i Kodit Penal); të miturit e kryejnë dënimin me burgim në vende të veçanta nga të rriturit. Sipas Kodit Penal (*nenit 52*), gjykata mund ta përjashtojë të miturin nga dënimi, kur vlerëson rrezikshmërinë e pakët të veprës penale, rrethanat konkrete të kryerjes së saj, si dhe sjelljen e tij të mëparshme. Në rastet e përjashtimit nga dënimi i mituri mbyllet në një institucion edukimi.

Kodi i Procedurës Penale parashikon se gjykimi i të miturve bëhet nga seksionet përkatëse, të krijuara në gjykatat e rretheve gjyqësore, të përcaktuara me dekret të Presidentit. Gjithashtu, në këtë Kod parashikohet se të pandehurit të mitur i sigurohet ndihmë juridike dhe psikologjike, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, me praninë e prindit ose të personave të tjerë të kërkuar nga i mituri dhe të pranuar nga autoriteti që procedon.

Ligji nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar më 2008, në zbatim të të cilit përcaktohet se të dënuarit duhet të trajtohen me programe që synojnë integrimin e tyre në jetën shoqërore (*neni 9*). Për të dënuarit e mitur bëhet një program i posaçëm dhe favorizues për lidhjet me familjen. Ndërkohë që në *nenin 53* të këtij ligji, parashikohen se masat disiplinore për të miturit janë:

- Qortim individual;
- Vërejtje në prani të të dënuarve;
- Përjashtim nga veprimtari të veçanta, të përbashkëta;
- Përjashtim nga ajrosja në grup;
- Përjashtimi nga të gjitha veprimtaritë e përbashkëta;
- Ndërprerja e lejeve.

Ligji nr. 10 039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”, përcakton kushtet, llojin, mënyrën dhe procedurat për dhënien e ndihmës juridike nga shteti, për mbrojtjen e lirive e të të drejtave themelore të individit, si dhe të interesave të tjerë të tij të ligjshëm. Në këtë ligj sanksionohet dhënia e ndihmës juridike të të miturve në konflikt me ligjin.

Me qëllim ofrimin e një procesi ligjor të drejtë për çdo qytetar dhe institucionalizimin e asistencës ligjore falas për grupet në nevojë, Ministria e Drejtësisë përgjatë vitit 2008 ndërmori një iniciativë ligjore për hartimin e një ligji për ndihmën juridike falas, i cili u miratua në fund të vitit 2008 nga Kuvendi i Shqipërisë. Në ligjin nr. 10 039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”, është parashikuar dhënia e ndihmës juridike falas për të miturit në konflikt me ligjin.

Me ligjin nr. 10 024, datë 27.11.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, krijohet për herë të parë shërbimi i provës, i cili do të mbikëqyrë ekzekutimin e dënimeve alternative dhe do t’u vijë në ndihmë të miturve të përfitojnë më shumë nga këto dënime alternative. Kur gjykata vendos pezullimin e vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me një dënim alternativ, dërgon menjëherë vendimin te Shërbimi përgjegjës i Provës për ekzekutimin e dënimit alternativ.

Në nenin 63 të KP, të ndryshuar me ligjin nr. 10 023, datë 27.11.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” për punën në interes publik parashikohet pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik, të cilën e vendos për shkak të rrezikshmërisë së pakët të personit dhe të rrethanave të kryerjes së veprës penale, kur ka caktuar një dënim gjer në një vit burgim, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me detyrimin që i dënuari të përmbushë një punë në interes publik.

Legjislacioni ynë penal përcakton se moshë për përgjegjësi penale për krime është 14 vjeç, ndërsa për kundërvajtje penale është 16 vjeç (neni 12 i Kodit Penal). Përgjegjësia penale lidhet me moshën e personit që ka kryer krimin. Ajo vendoset pasi vlerësohet pjekuria apo aftësia e të miturve për të kuptuar veprimet e tyre dhe pasojat që sjellin këto veprime. Institucionet e paraburgimit për të miturit në Shqipëri gjenden në Lezhë, Vlorë, Korçë, Durrës dhe në Tiranë. Aktualisht numri i tyre është 57¹³, por ky numër ndryshon në mënyrë të vazhdueshme. Të dhënat statistikore për kriminalitetin e të miturve për vitin 2008, krahasuar me ato të viteve të mëparshme, na tregojnë një rritje të fenomenit.

Tabela 5:
Të dhëna statistikore për kriminalitetin e të miturve


Të dënuar të mitur	2003	2004	2005	2006	2007	2008
Për krime	259	313	258	238	198	356
Për kundërvajtje	49	7	31	30	13	51
Totali	308	320	289	268	211	407

Burimi: Vjetari Statistikor, Tiranë 2009, Botim i Ministrisë së Drejtësisë

Në mbështetje të ligjit 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, të ndryshuar, në zbatim të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, si dhe në kuadër të trajtimit të diferencuar të kategorive vulnerabël, të gjithë të dënuarit dhe të paraburgosurit deri në 18 vjeç për vitin 2008 dhe 6-mujorin e parë të vitit 2009 kanë vuajtur dënimin në seksione të veçanta për të mitur në I EVP. Gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur raste që këta të dënuar të jenë vendosur në dhoma (qeli) me të dënuarit e rritur. Sërish, duke iu referuar të dhënave të Vjetarit Statistikor për vitin 2008, rezulton se nga 407 të miturit të dënuar në vitin 2008, 68 prej tyre janë pa arsim. Megjithatë për të miturit e dënuar nga gjykatat nuk ka të dhëna për shkallën e arsimimit.

13 www.dpbsh.gov.al, data e aksesit 9 dhjetor 2009

Tabela 6:
Të mitur që vuajnë dënimin



Burimi: Vjetari Statistikor, Tiranë 2009, Botim i Ministrisë së Drejtësisë

Megjithatë ka inisiativa pozitive lidhur me arsimimin apo ndjekjen e arsimit profesional nga të miturit në konflikt me ligjin. Në datën 05.12.2008 u nënshkrua Memorandumi i Bashkëpunimit midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, për arsimimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, sipas programeve mësimore të miratuara nga MASH-i. Në kuadër të zbatimit të këtij memorandumi ka përfunduar procesi mësimor për vitin akademik 2008-2009 në 4 Institucione të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP Fushë-Krujë, Peqin, Korçë dhe Vaqar). Në fund të vitit akademik, u pajisën me dëftesa 94 të burgosur. Në muajin tetor filloi procesi mësimor për vitin akademik 2009-2010 në IEVP Fushë-Krujë, Peqin dhe Korçë, ndërkohë që po ndërmjetësohet me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e memorandumit në 6 institucione të tjera penitenciare, konkretisht: në Burrel, Lezhë, Rrogozhinë, Lushnjë, Durrës dhe Kavajë.

Me kërkesë të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, në Korrik 2009, u nënshkrua Memorandumi i Bashkëpunimit midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, mbi realizimin në praktikë të së drejtës për formim profesional të të paraburgosurve dhe të dënuarve që ndodhen në IEVP, në funksion të aftësimit për punë dhe të riintegritit të tyre në shoqëri. Ky memorandum, zyrtarizoi kurset e formimit profesional, të cilat më parë janë zhvilluar në mënyrë informale nga OJF të ndryshme.

Paraqitet tejet shqetësues fenomeni i vetëgjyqësisë dhe i gjakmarrjes, i cili reflekton mungesa në garantimin e jetës së personave, veçanërisht të fëmijëve, të cilët janë detyruar të ngujohen dhe të privohen nga të gjitha të drejtat bazë. Prej vitit 1991 deri sot janë ngjuar mbi 6000 familje, duke izoluar gratë dhe fëmijët jashtë çdo rregulli "kanunor". Një pjesë e madhe e këtyre familjeve kanë emigruar ilegalisht jashtë vendit për t'i shpëtuar humbjes së jetës, megjithatë shifrat tregojnë për një rritje të numrit të familjeve të ngjuara në vite: nga 780 familje të ngjuara e të fshehura në vitin 2005, ky numër ka arritur në 1430 në vitin 2008. Vetëm në Tiranë, kryeqytetin e vendit, ndodhen 110 familje të ngjuara dhe 70 të fshehura, midis të cilave edhe familje të përfaqësuesve të policisë së shtetit. Fëmijët e këtyre familjeve nuk dalin dot as deri te pragu i shtëpisë së tyre, sepse kanë frikë se mos i vrasin. Pa përmendur këtu që këta fëmijët nuk kanë mundësi as për shërbime shëndetësore dhe kanë vite që nuk frekuentojnë shkollën.¹⁴

14 Referuar Draft-Strategjisë kombëtare kundër gjakmarrjes, përgatitur nga Komiteti i Pajtimit Mbarëkombëtar

3. Politikat që garantojnë të drejtën e fëmijëve për të mos u diskriminuar

Parimi i mosdiskriminimit është një e drejtë e njeriut në vetvete dhe njëkohësisht edhe elementi thelbësor apo bazik për strukturën e të gjitha të drejtave të njeriut. Ai është njëri nga parimet bazë të Konventës. Çdo fëmijë duhet të gëzojë të drejtat e Konventës pa diskriminim. Sigurisht parimi i mosdiskriminimit është i lidhur me atë të trajtimit të barabartë.

Komiteti Shqiptar për të Drejtat e Njeriut është duke përgatitur një projekt-ligj kundër diskriminimit, ndërsa MPCSSHB sapo ka përfunduar procesin e përgatitjes së projekt-ligjit “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”, akt ky i nisur që nga fundi i vitit 2008. Parimi i mosdiskriminimit, specifikisht për fëmijët, nuk gjendet i pasqyruar në legjislacionin kryesor, por trajtohet në parimin e barazisë së qytetarëve, në parimet e përgjithshme të legjislacionit shqiptar. Në SKF-në, përcaktohet qartë sigurimi i mundësive të barabarta për të gjithë fëmijët, pavarësisht moshës, gjinisë, etnisë, aftësisë së kufizuar apo statusit të lindjes dhe tenton të bëjë një përkufizim të fëmijëve vulnerabël ndaj diskriminimit; si p.sh.: *fëmijë të ngujuar, fëmijë të braktisur, fëmijë të trafikuar, fëmijë të varfër, fëmijë romë* etj.

Gjatë dhjetë viteve të fundit, ndryshimet politike dhe socio-ekonomike në Shqipëri kanë rritur ndjeshmërinë e qytetarëve për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, shfrytëzimi, diskriminimi, abuzimi dhe neglizhimi. Shumë fëmijë shqiptarë vazhdojnë të përballen me një rrezik të madh, atë të përjashtimit. Gjithashtu, edhe personat me aftësi të kufizuar (PAK), personat e moshuar, gratë e vajzat dhe, në mënyrë të veçantë të zonave rurale, janë target grupet më të prekshme nga varfëria, kanë të ardhura të pakta, vuajnë mungesën e një infrastrukture të gjerë dhe të mirëshpërndarë sociale, shëndetësore, ekonomike, juridike si dhe janë viktima të dhunës në familje, trafikimit, HIV/AIDS, drogës, alkoolit, diskriminimit gjinor, moshor, racor etj.

3.1 E drejta e fëmijëve të komunitetit rom për t’u mbrojtur nga diskriminimi

Legjislacioni ynë nuk parashikon diskriminimin për motive racore apo për motive të tjera. Edhe dokumenti themeltar i shtetit shqiptar garanton mosdiskriminim dhe barazi të plotë para ligjit për personat që u përkasin pakicave kombëtare. Megjithatë, mungojnë statistika për identifikimin e grupeve të marginalizuara të shoqërisë.

3.2 E drejta e fëmijëve me aftësi të kufizuar për t’u mbrojtur nga diskriminimi

Kushtetuta e Shqipërisë, garanton brenda konceptit të gjendjes sociale mosdiskriminimin për fëmijët me aftësi të kufizuar, por mbetet ende problematike mungesa e një ligji anti-diskriminues të miratuar, si për fëmijët me aftësi të kufizuar, por edhe për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara, në tërësi. Gjithashtu, mungon një mekanizëm i pavarur ankimues për fëmijët me aftësi të kufizuara, i cili do të mundësonte shqyrtimin e rasteve të diskriminimit.

Në përputhje me kërkesat e nenit 23 të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës për fëmijët me

aftësi të kufizuara mendore dhe fizike, që ata të bëjnë jetë normale dhe të përshtatshme me dinjitet dhe autonomi, janë marrë masa duke ndihmuar gjendjen financiare të prindërve për të garantuar arsimin, kualifikimin, shërbimin shëndetësor, të riaftësimin, punësimin, argëtimin etj.

Personat me aftësi të kufizuara, të paaftë për të plotësuar totalisht ose pjesërisht nevojat e tyre për të bërë një jetë normale individuale ose sociale, si pasojë e paaftësisë së tyre fizike ose mendore, kanë të drejtën e respektimit të dinjitetit të tyre human, pa asnjë lloj diskriminimi. Në Shqipëri tema e paaftësisë i takon zonës së emergjencave sociale. Në 23 Mars 2006, pranë MPÇSSHB është ngritur Sekretariati Teknik për PAK, objektivi i të cilit është monitorimi i zbatimit të SKPAK-së. Konventa e OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”, ende nuk është ratifikuar. Njëkohësisht, ende nuk është miratuar projektligji për statusin e personave me aftësi të kufizuara mendore, fizike dhe shqisore. Në zbatim të VKM-së nr. 1104, datë 30.07.2008, është hartuar drafti i standardeve të shërbimit të kujdestarisë dhe u janë dërguar materialet për mendim grupeve të interesit¹⁵.

Qeveria Shqiptare është angazhuar në përpunimin e disa udhëzimeve të përgjithshme, të cilat do të ndihmojnë në garantimin e të drejtave për personat me aftësi të kufizuara në nivel kombëtar. Pjesë e këtij procesi është edhe niveli i deinstitutionalizimit dhe decentralizimit të shërbimeve. Në strategjinë kombëtare për PAK-në, bazuar në ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, janë parashikuar:

- Ndërtimi i rrjeteve operative në territorin midis subjekteve sociale që operojnë në të njëjtën fushë.
- Vlerësimi i shërbimeve në varësi të integritetit të tyre social e plotësimin të nevojave.
- Promovimi i autonomisë në varësi të moshës së personit me aftësi të kufizuara.
- Garancia mbi informimin e njohjes së shërbimeve.
- E drejta për këto shërbime të garantuara.
- Barazia e trajtimit nga persona dhe organizata, me të drejtën e ankimimit.

Trajtimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në vendin tonë, ofrohet në këto drejtime:

- Shërbime sociale rezidenciale, ditore publike;
- Shërbime sociale jopublike;
- Shërbime sociale me bazë komunitare;
- Trajtim me pension invaliditeti.

Nga pikëpamja gjeografike këto institucione janë të vendosura në Tiranë, Shkodër, Lezhë, Berat, Korçë, Vlorë, Durrës. I gjithë shërbimi social për personat me aftësi të kufizuara deri në vitin 2002 ka qenë i mbizotëruar nga dy format klasike: shërbimi rezidencial në institucione dhe qendra të zhvillimit dhe programi qeveritar i mbështetjes ekonomike të personave, me pagesën e paaftësisë dhe në raste të tjera edhe me pagesën e kujdestarisë. Procesi i deinstitutionalizimit ka si qëllim lëvizjen e përfituesve nga shërbimet rezidenciale në alternativa të tjera shërbimesh, si shtëpitë-familje, jetesa gjysmë e pavarur, apartamente të mbrojtura etj. P.sh., në Shkodër janë ngritur 6 shtëpi familje, me atelie pune dhe veprimtari të tjera riintegruese, ku trajtohen 54 fëmijë. Ky model, financohet nga burime të shoqatës dhe fonde të buxhetit të shtetit.

15 “Raporti Vjetor i Monitorimit të Shqipërisë në Procesin e Stabilizim –Asociimit” - SOROS

Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara, bazuar në VKM nr. 872 dt.18.06.2008 “Të masës së përfitimit të personave me aftësi të kufizuara”, të ligjit “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, përcaktohet trajtimi i fëmijëve me pension invaliditeti. Përfaqja synon që këta fëmijë të kenë mundësi të marrin arsim, kualifikim, shërbime shëndetësore, shërbime riaftësimi, përgatitje për punësim dhe veprimtari argëtuese, në mënyrë që t’u sigurohet një integritet shoqëror dhe zhvillim vetjak sa më i plotë, përfshirë zhvillimin kulturor dhe shpirtëror.

Kuadri ynë ligjor garanton ofrimin e shërbimeve shëndetësore, shërbimeve shoqërore, arsimim, për kohën e lirë, formim profesional dhe punësim për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me fëmijët e tjerë. Mirëpo, nuk parashikohen masa specifike për mbrojtjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në mjediset familjare apo në komunitet duke e trajtuar këtë kategori nën kuadrin e përgjithshëm të termit *fëmijë* apo *persona me aftësi të kufizuara*. Në këtë aspekt, duhet të miratohen akte ligjore e nënligjore, specifike, për të garantuar mbrojtjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara nga dhuna në familje dhe komunitet, si dhe për të rritur ndërgjegjësimin në lidhje me shfaqjen e kësaj forme dhune.

4. Politikat që garantojnë të drejtën e fëmijëve për të përfituar shërbime bazë

4.1 Vlerësim i mundësive për shërbime bazë të fëmijëve, familjeve dhe komuniteteve

Kushtetuta e Shqipërisë, në nenin 54 të saj përcakton se “*fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja, kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti. Fëmijët e lindur jashtë martesë kanë të drejta të barabarta me të lindurit nga martesë. Çdo fëmijë, ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën e zhvillimin e tij normal*”. Megjithatë, ende nuk është realizuar një studim gjithëpërfshirës dhe krahasimor, për të vlerësuar masat dhe kuadrin ligjor në funksion të zbatimit të KDF-së.

Mbetet për t’u vlerësuar iniciativa e shoqërisë civile për realizimin e një studimi krahasimor, të KDF-së me legjislacionin shqiptar, për periudhën nga ratifikimi i saj deri në vitin 2007. Ky studim përfaqëson një analizë gjithëpërfshirëse, që synon krijimin e instrumenteve të nevojshme, për të evidentuar arritjet dhe mangësitë e legjislacionit shqiptar, në lidhje me zbatimin e standardeve që vendos Konventa për të Drejtat e Fëmijës. Nëpërmjet analizës dhe rekomandimeve konkrete, studimi shërben si bazë për të punuar për përmirësimin e legjislacionit shqiptar nga institucionet përgjegjëse shtetërore si dhe për të përforcuar punën lobuese të organizmave të Avokatit të Popullit dhe organizatave kombëtare e ndërkombëtare që punojnë në Shqipëri për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.

4.2 Aksesit në arsimin e detyruar

Aksesit në arsimin parauniversitar paraqitet në nivel të ulët në krahasim me vendet e OECD. Aktualisht, në Shqipëri mesatarja e ndjekjes së shkollës është 11,9 vjet (*vendet e OECD: 14 vjet*), gjë që shpjegohet me shkallën e ulët të frekuentimit të arsimit të mesëm.¹⁶ Në kuadër të lehtësimit të aksesit në arsimin parashkollor, veçanërisht në zonat rurale ku ka edhe frekuentim më të ulët, vitet e fundit janë bërë përpjekje për përmirësimin e infrastrukturës dhe zgjerimin e koncepteve e praktikave bashkëkohore që aplikohen në disa kopshte pilot. Arsimit bazë është i detyrueshëm me ligj. Ai zgjat 9 vjet dhe është baza e gjithë arsimit parauniversitar. Të dhënat tregojnë se, ka pasur një rënie të numrit të nxënësve që kanë përfituar dëftesën e liritimit pas përfundimit të arsimit të detyruar, gjatë vitit 2007-2008 në krahasim me vitin 2006-2007, jo vetëm në total, por edhe në aspektin gjinor, sipas të cilit femrat janë më pak në numër.

Tabela 7:
Nxënës që kanë mbaruar Arsimin 9-vjeçar dhe morën Dëftesë Lirimi

Viti shkollor	Gjithsej	Femra
2006 - 07	55 785	27 242
2007 - 08	54 034	26 429

Burimi: Të dhënat statistikore janë marrë nga INSTAT¹⁷

Ndonëse numri i djemve të regjistruar në arsimin fillor është më i lartë në raport me vajzat, në arsimin e mesëm vajzat përbëjnë një numër më të madh në raport me djemtë. Kjo lidhet me nevojat ekonomike që i detyrojnë djemtë të punojnë, për t'u kujdesur për familjen. Gjithashtu, këto të dhëna mund të konsiderohen edhe si tregues që sjell braktisjen e shkollës nga djemtë për arsye e lartpërmendur.

Tabela 8:
Numri i nxënësve që ndjekin Arsimin Bazë të Detyruar sipas gjinisë¹⁸

Vitet	Total	Femra	Meshkuj
2006 - 07	447 302	215 689	231 613
2008 - 09	457 886	220 206	237 680

Legjislacioni aktual për fëmijët që iu përkasin pakicave kombëtare, parashikon krijimin e mundësive për të mësuar në gjuhën e tyre amtare, historinë dhe kulturën e tyre brenda kuadrit të planeve dhe programeve mësimore. Sipas MASH-it, edhe pse janë rreth 5000-5500 nxënës në arsimin parauniversitar që përfitojnë bursa, mungon informacioni për numrin e bursave të akorduara romëve, pasi nuk ka standard ligjor apo ndonjë VKM të veçantë për ta. Gjithashtu, problematik paraqitet arsimimi parauniversitar i fëmijëve me aftësi të kufizuar mendore dhe atyre me aftësi të kufizuar në dëgjim dhe në të folur. Kuadri ligjor garanton ofrimin e arsimimit për këto kategori deri në sistemin 9-vjeçar. Kjo sjell si domosdoshmëri rishikimin në tërësi të akteve ligjore, që parashikojnë arsimin gjithëpërfshirës dhe në baza të barabarta, si për fëmijët me aftësi të kufizuar, edhe për ata pa aftësi të kufizuar, si dhe miratimin e kurrikulës arsimore gjithëpërfshirëse. Në të njëjtën problematikë paraqiten edhe fëmijët me probleme në dëgjim në lidhje me mos standardizimin ende të gjuhës së shenjave nga shteti shqiptar. Kjo krijon boshllëqe në arsimimin e tyre. Në fushën e arsimimit, kuadri ligjor parashikon ofrimin e një ndihme të

16 MASH, (Korrik 2009) *Strategjia kombëtare e Arsimit Parauniversitar 2009-2013*

17 www.instat.gov.al

18 po aty

veçantë për të nxitur arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar¹⁹, por problematik mbetet moszbatimi i kësaj të drejte në praktikë. Për kategorinë e fëmijëve me aftësi të kufizuara fizike, problematik mbetet aksesimi në ndërtesat arsimore, që e bëjnë të pamundur përfshirjen në arsimim të kësaj kategorie fëmijësh, ku pjesa më e madhe e tyre qëndrojnë të mbyllur në shtëpi dhe të paarsimuar për një kohë të gjatë. Ky fenomen në mënyrë të veçantë është ndeshur në zonat rurale, por pa lënë mbrapa edhe zonat urbane (periferitë e qyteteve të mëdha).

4.3 Aksesimi në shërbime shoqërore

Fëmijët gëzojnë të drejtën për mbrojtje sociale dhe sigurime shoqërore. Kushtetuta nuk i ka trajtuar në mënyrë të veçantë të drejtat e fëmijëve në fushën e përkrahjes sociale dhe të sigurimeve shoqërore dhe nuk ekziston legjislacioni specifik në Shqipëri që mbulon mbrojtjen e fëmijëve. Ligji “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” parashikon ndihmën dhe shërbimet shoqërore që duhet të përfitojnë nga shteti individët dhe grupet në nevojë. Pjesë e mbrojtjes shoqërore për zbutjen e pasojave të varfërisë, është dhe ndihma ekonomike, për familjet pa të ardhura, me të ardhura të pamjaftueshme jetese dhe për ato familje me më shumë se dy fëmijë të lindur njëherësh.

Ndihma ekonomike, për kategoritë e përcaktuara më lart, jepet në formën e një kësti mujor, në lekë ose përfitimi mujor, në natyrë. Në zbatim të ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, i ndryshuar”, personat që kanë nevojë për shërbime të përkujdesit shoqëror pranohen në institucionet rezidenciale publike pa pagesë, nëse familjet e tyre nuk kanë asnjë të ardhur. Shërbimet shoqërore publike përfshijnë shërbimet e përkujdesit shoqëror që ofrohen për grupet në nevojë në institucionet rezidenciale, qendrat ditore ose në shtëpi. Këto shërbime financohen nga buxheti qendror dhe nga buxhetet e pavarura të organeve të qeverisjes vendore. Shërbimet shoqërore private përfshijnë shërbimet e përkujdesit shoqëror që ofrohen në qendrat rezidenciale, në qendrat ditore apo në shtëpi të financuara privatisht.

Në kuadër të decentralizimit bashkitë dhe komunat administrojnë të gjitha shërbimet shoqërore për individët, që janë banorë të atij qyteti apo komune. Funksionimi i institucioneve publike të përkujdesit shoqëror për të gjithë vendin, por që janë të vendosura në qendrat më të mëdha urbane, paraqiten si me poshtë:

- Në vitin 2007, funksionin 8 shërbime publike²⁰, që ofronin shërbime për personat me aftësi të kufizuar e që u frekuentuan nga 325 persona, nga të cilët 154 gra. Gjithashtu, funksiononin 15 qendra rezidenciale jopublike, që u frekuentuan nga 660 persona, nga të cilët 377 femra. Ndërsa në vitin 2008 ka një rritje të numrit të shërbimeve që ofrohen për personat me aftësi të kufizuara, konkretisht funksionuan 7 qendra rezidenciale publike, si dhe 4 qendra ditore publike, që u frekuentuan nga 381 persona, nga të cilët 168 femra.

19 Udhëzim nr. 2472, datë 06.12.2006, “Për përcaktimin e kritereve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës të personave me aftësi të kufizuar”- ofrimin e 2-fshit të pagesës së aftësisë të kufizuar (aktualisht kjo pagesë është në nivelin e 8700 lek në muaj, kur fëmija ndjek arsimin parauniversitar dhe 3-fshin e pagesës së aftësisë të kufizuar, kur fëmija ndjek arsimimin universitar.

20 MPÇSSHB, Statistika 2007 dhe 2008 (Në qarqet: Tiranë, Durrës, Korçë, Elbasan, Shkodër, Vlorë, Lezhë)

- Në vitin 2007, ishin në shërbim 8 qendra publike²¹ të përkujdesit për të moshuarit, nga të cilat 4 institucione rezidenciale publike dhe 4 qendra ditore për 456 të moshuar. Gjithashtu, funksionuan 8 qendra rezidenciale dhe ditore jopublike, të cilat u frekuentuan nga 285 persona, nga të cilët 108 femra. Ndërsa në vitin 2008, funksionuan 12 qendra rezidenciale dhe ditore publike, nga të cilat 4 janë rezidenciale dhe 8 ditore, me një frekuentim prej 698 të moshuarish, nga të cilët 163 femra.
- Në vitin 2007, funksionuan 16 qendra publike të përkujdesit për fëmijët, nga të cilat 13 janë rezidenciale dhe 3 ditore, e që u frekuentuan nga 393 fëmijë. Gjithashtu, funksionuan 41 qendra jopublike, nga të cilat 16 rezidenciale dhe 25 ditore, që u frekuentuan nga 2 296 fëmijë. Për vitin 2008, funksionuan 11 qendra publike, nga të cilat 9 rezidenciale dhe 2 ditore, që u frekuentuan nga 400 fëmijë. Numërohen 50 qendra jopublike, nga të cilat 16 janë rezidenciale dhe 34 ditore, me një frekuentim prej 7 661 fëmijë.

Legjislacioni aktual i skemës së mbrojtjes shoqërore, nuk parashikon mbrojtjen e të gjitha kategoritë e fëmijëve, të identifikuar në rrezik përjashtimi social nga Strategjia Ndërsëktoriale e Përfshirjes Sociale, 2008-2013, e cila i bën një vlerësim fillestar situatës dhe problemeve ekzistuese të kësaj skeme, sipas kategorive të këtyre fëmijëve. Megjithatë, reformimi i plotë i skemës së mbrojtjes shoqërore, mbetet problematik për shkak të mungesës së vlerësimit real të situatës së varfërisë në vend dhe analizës jo të plotë të përjashtimit social 22.

Problematike paraqitet përkujdesja shoqërore për atë kategori fëmijësh në nevojë, të cilët prindërit vendosin t'i lënë në përkujdesje institucionale, për shkak të kushteve të vështira ekonomike. Roli i strukturave të shërbimit social në këto raste nuk është mbështetja e këtyre familjeve që të mos braktisin fëmijët të tyre, por limitohet vetëm në vlerësimin e dokumentacionit përkatës²³. Vlen të theksohet se Qeveria ka pasur sensibilizimin për deinstitutionalizimin e fëmijëve në nevojë dhe aplikimin e alternativave të reja të shërbimeve sociale (kujdestarisë së fëmijëve) të pasqyruara në Planin Kombëtar të Veprimeve për vitet 2005-2010 dhe në Strategjinë Sektoriale të Ministrisë së Punës 2007-2013. Me iniciativë të MPCSSH-së dhe mbështetje të UNICEF-it, është miratuar Strategjia e kujdestarisë për fëmijët në nevojë, ku ndër të tjera parashikohet si fillim, të pilotohet ky shërbim në Tiranë dhe Shkodër për 80 raste, në vitet 2009-2010, për të vazhduar më pas me një shtrirje graduale në nivel kombëtar.

4.4 Aksesi në shërbimet shëndetësore

E drejta e fëmijëve për shëndet dhe mbijetesë, garantohet në pjesën më të madhe nga shërbimet shëndetësore publike, në të tria nivelet e kujdesit shëndetësor. *Fëmijë* - në sistemin tonë shëndetësor, konsiderohen grupmoshat 0-14 vjeç (mosha pediatrike). Mbi këtë moshë shërbimet shëndetësore janë ato të moshës së rritur. Ministria e Shëndetësisë është ofruesi kryesor i kujdesit shëndetësor në Shqipëri. Ajo e ofron këtë kujdes përmes një rrjeti të gjerë spitalësh, poliklinikash dhe qendrash të kujdesit shëndetësor parësor. Sektori privat është ende në hapat e tij të parë dhe mbulon pjesën më të madhe të shërbimit farmaceutik, shërbimit stomatologjik dhe disa klinika diagnostikuese, të cilat janë përqendruar kryesisht në Tiranë. Shërbimet e shëndetit publik dhe promovonit e të edukimit shëndetësor ofrohen në kuadrin e shëndetit parësor dhe mbështeten e mbikëqyren nga ISHP-ja. Shërbimi për fëmijët në kujdesin parësor, fillon që në zonat rurale, ku funksionojnë qendrat e kujdesit shëndetësor, me personel të mesëm mami-infermiere. Ato ofrojnë

21 Po aty. Në qarqet: Tiranë, Durrës, Vlorë, Korçë, Fier, Elbasan, Shkodër

22 Progres-raporti i Marrëveshjes së Stabilizimit Asocimit të Shqipërisë me BE-në, 2008, f.38.

23 Pika 2, Udhëzimi nr. 2470, datë 6.12.2006 i MPCSSH-së.

shërbimet bazë shëndetësore lidhur me parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve të banorëve të fshatit. Në paketën e këtyre shërbimeve ofrohet edhe kujdesi për nënën dhe fëmijën. Ky kujdes ofron ndjekjen e rregullt të gruas gjatë shtatzënisë, lindjen normale në shtëpinë e lindjes që mund të ketë qendra, kujdesin pas lindjes, vaksinimet, dhënien e ndihmës së parë urgjente dhe referimin, vizitat në shtëpi, promocionin dhe edukimin shëndetësor për këto kategori.

Shërbimet parandaluese të kujdesit shëndetësor për fëmijët, këshillimoret e fëmijës dhe qendrat shëndetësore e ambulancat, me një udhëzim të MSH-së, kryejnë vizita të detyrueshme kontrolli, për të siguruar mirëritjen e fëmijës. Për vitin e parë janë 13 vizita, gjatë moshës 12-24 muajsh nga një vizitë në çdo tre muaj dhe nga një vizitë në çdo gjashtë muaj për fëmijët në moshën 2-6 vjeç. Në këto shërbime për fëmijët mungojnë ekipet multidisiplinore si dhe punonjësit social.

Mbas moshës 6-vjeçare, fëmijët duhet të ndiqen nga mjeku i shkollës, shërbim ky që nuk është i shpërndarë dhe rregulluar mirë në të gjitha rrethet e vendit. Ai rregullohet sipas një rregulloreje të përbashkët të firmosur nga dy ministrat (i Shëndetësisë dhe Arsimit). Ministria e Shëndetësisë për vitin 2009, në kuadrin e projektit kombëtar të bashkëpunimit me Qeverinë e Spanjës, “Për reformimin e shërbimeve të kujdesit ndaj nënës dhe fëmijës”, do të filloj punën për riorganizimin e këtij shërbimi.

4.5 Krijimi i kapaciteteve njerëzore për trajtimin e dhunës në familje

Për trajnimin e mësuesve është institucionalizuar sistemi vertikal i trajnimeve. Shkresa nr. 22, datë 18.08.2009, urdhëron përdorimin e fondeve të trajnimit të punonjësve mësimorë në Arsimin Parauniversitar. Sistemi vertikal i trajnimit u jep mundësi të gjithë mësuesve dhe punonjësve të arsimit të marrin trajnime, përfshi këtu edhe tematika, që lidhen me dhunën. Ministria e Shëndetësisë, në bashkëpunim me UNFPA-në, nëpërmjet Qendrës Kombëtare për Studime Sociale (NCSS), po përgatitet të fillojë trajnimin e 1 800 punonjësve të shëndetësisë (mjekë të përgjithshëm, infermierë, specialistë etj.) për problemet e dhunës në familje.

Nga shkolla e Magjistraturës, në bashkëpunim me PNUD-in, në kuadër të programeve “Dhuna në familje” dhe “Përkatësia gjinore”, janë trajnuar përkatësisht 84 dhe 79 gjyqtarë dhe prokurorë. Gjatë vitit 2008, Departamenti për Trajnimin Policor” në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ka zhvilluar një cikël trajnimesh lidhur me rolin e policisë për rastet e dhunës në familje, ku u trajnuan 690 punonjës policie. Trajnimet e punonjësve të policisë do të vazhdojnë edhe gjatë vitit 2009. Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit, në bashkëpunim dhe me mbështetjen financiare të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, ka zhvilluar trajnimin e përmbarruesve gjyqësor për ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, përqendruar në detyrën e tyre për ekzekutimin e urdhrave të mbrojtjes në mënyrë të menjëhershme, duke siguruar përmbushjen e tyre në përputhje me nenin 23/6 si dhe për të ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura.

Nga ana e Mjekësisë Ligjore, në kuadër të programit kundër dhunës në familje, janë trajnuar gjithsej 14 ekspertë mjeko-ligjorë. Në të gjitha Drejtoritë e Policisë në qarqe është përgatitur dhe shpërndarë “Manuali” i Departamentit për Hetimin e Krimeve dhe Departamentit të Rëndit dhe Sigurisë Publike “Mbi procedurat standarde që duhet të zbatojë punonjësi i Policisë së Shtetit, në marrjen e masave për parandalimin e dhunës dhe mbrojtjen e kujdesin për viktimat e kësaj dhune”. Në kuadër të përsosjes së sistemit të informacionit lidhur me të drejtat e viktimave të

dhunës në familje dhe garancitë e tyre procedurale prej sistemit të drejtësisë, janë përgatitur fletëpalosje me të drejtat procedurale dhe janë vendosur ato edhe në mjedise të aksesueshme prej publikut.

4.6 Identifikimi i problemeve që lidhen me mundësinë e përdorimit të shërbimeve të domosdoshme shoqërore

4.6.1 Ndhimja ekonomike

Ligji “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” ka për qëllim të përcaktojë ndihmën dhe shërbimet shoqërore për individët dhe grupet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive dhe të mundësive personale dhe ruajtjen e integritetit për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore. Ky ligj synon të zbusë varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët dhe familjet, si dhe të krijojë mundësi për integrimin e tyre, nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrjesh e shërbimesh për përmirësimin e jetesës së tyre. Parimet bazë mbi të cilat funksionon skema e ndihmës dhe e shërbimeve shoqërore janë: *respektimi dhe garantimi i vlerave dhe i personalitetit të individit, universaliteti, barazia e mundësive, e drejta për të përfituar, partneriteti, pavarësia, integrimi shoqëror dhe pjesëmarrja në jetën e komunitetit, mosdiskriminimi dhe karakteri subvencionues*. Sipas këtij ligji, me *shërbime shoqërore* kuptohet: tërësia e shërbimeve që u ofrohet individëve dhe grupeve në nevojë, të cilët nuk janë në gjendje të përballojnë me burimet që kanë, nevojat e tyre jetësore për ruajtjen, zhvillimin dhe rehabilitimin e mundësive individuale, për të kapërcyer nevojat emergjente ose kronike.

Shërbimet shoqërore, sipas natyrës, ndahen në:

- a) shërbime të përkujdesit shoqëror;
- b) shërbime të përkujdesit shoqëror-mjekësor.

Shërbimet e përkujdesit shoqëror, sipas mënyrës së organizimit dhe të funksionimit, janë:

- a) shërbime të përkujdesit rezidencial;
- b) shërbime të përkujdesit komunitar.

Përfituesit e shërbimeve shoqërore janë fëmijët, të rinjtë deri në moshën 25 vjeç, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, gratë, vajzat në nevojë, si dhe të gjithë ata që janë në rrezik e që bëjnë pjesë në grupet në nevojë. Fëmijët e mitur, janë përfitues të drejtpërdrejtë të shërbimeve shoqërore të kategorizuara më sipër. Ligji pasqyron rëndësinë e respektimit të të drejtave të njeriut për çdo shtetas që bëhet përfitues i shërbimeve shoqërore, duke përfshirë në kategorinë e përfituesve edhe të miturit, si përfitues të drejtpërdrejtë dhe jo të drejtpërdrejtë. Shërbimet shoqërore, të drejtuara për të gjitha grupet në nevojë, si: fëmijët, gratë, personat me aftësi të kufizuara, të rinjtë në nevojë, të moshuarit etj., synojnë plotësimin më mirë të nevojave të tyre. Ndhimja ekonomike (NE), është një program që ofron garanci minimale dhe pagesa në formën e transfertave në “cash” për familjet e varfra pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme. Përfitues të ndihmës ekonomike janë: familjet në nevojë, jetimët nën 25 vjeç, të papunë, të cilët nuk janë në institucione ose nën kujdestari, prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, e që u përkasin familjeve në nevojë. Ky ligj, ashtu sikurse edhe Kushtetuta, nuk i ka trajtuar në mënyrë të veçantë fëmijët si subjekte të drejtpërdrejtë të përfitimit të ndihmës ekonomike, por kjo i atribuohet familjes dhe përmes saj përfitojnë fëmijët e mitur.

1. SITUATA MAKROEKONOMIKE DHE BUXHETORE PËR VITIN 2009

Shqipëria, një prej pak vendeve të cilat kanë pasur një rritje ekonomike të lartë e të qëndrueshme prej mbi 6 përqind për gati një dekadë, është duke kaluar një “momentum” pozitiv ekonomik. Kjo konfirmohet me ecurinë e ekonomisë gjatë dy viteve të fundit, ku me gjithë problemet në energjinë elektrike, thatësirën në bujqësi e së fundmi krizën financiare e rënien ekonomike globale, rritja ekonomike vazhdon të jetë në nivele relativisht të larta.

Krahas progresit teknologjik e reformimit strukturor të ekonomisë, zbatimi gjatë këtij trevjeçari i një sërë politikash e reformash makroekonomike, të orientuara qartë nga “filozofia” e stimulimit të rritjes ekonomike nëpërmjet nxitjes së ofertës agregate, i kanë dhënë një shtysë ekonomisë. Ndjekja e politikave makroekonomike të planifikuara e të koordinuara dhe thellimi i mëtejshëm i reformave ekonomiko-strukturore, krahas proceseve të tjera të natyrshme në të cilat po kalon ekonomia, si: progresi teknologjik, akumulimi i kapitalit e ristrukturimi i ekonomisë drejt një ekonomie gjithnjë e më efektive, do të sigurojnë që kjo ecuri ekonomike të vazhdojë e tillë të paktën edhe për një të periudhë afatmesme.

Gjithashtu, autoritetet përgjegjëse për hartimin dhe ndërmarrjen e politikave makroekonomike janë plotësisht të fokusuar në zhvillimet e mëtejshme dhe janë plotësisht të angazhura që nëpërmjet këtyre politikave të injektojnë stimuj shtesë në ekonomi në kohën dhe në masën optimale, me qëllim lehtësimin sa më tepër të efekteve negative që mund të vijnë nga zhvillimet e tregjeve të huaja. Politika fiskale e parashikuar dhe e ndjekur për vitin 2009 ka rezultuar mjaft e përshtatshme për këtë situatë ekonomike.

Për vitin 2009 u parashikua një nivel i lartë investimesh publike, kryesisht në infrastrukturën rrugore, por jo vetëm. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2009 investimet publike të planifikuara u realizuan në nivele të larta. Në afatin e shkurtër këto investime do të ndihmojnë të mbajnë në nivele të larta kërkesën agregate, e rrjedhimisht prodhimin, punësimin, të ardhurat e konsumin në ekonomi, ku risku për një kontraktim të mundshëm të tyre përbën dhe shqetësimin kryesor afatshkurtër. Nga ana tjetër duke qenë se investimet në infrastrukturë në vendin tonë kanë një kthyeshmëri mjaft të lartë, kjo politikë fiskale e prirur drejt investimeve në infrastrukturë shihet mjaft efektive edhe në këndvështrimin afatgjatë të ekonomisë.

Gjithashtu, sa i përket efikasitetit të politikës fiskale për të nxitur ekonominë në afatin e shkurtër, një tjetër aspekt mjaft pozitiv i kësaj politike është financimi me kapitale të huaja i një pjese të konsiderueshme të investimeve të planifikuara, duke i lënë kështu të gjithë hapësirën e nevojshme biznesit vendas që të vazhdojë të kreditohet nëpërmjet kapitalit vendas e të vazhdojë normalisht aktivitetin e tij ekonomik. Në buxhetin e vitit 2009 është parashikuar edhe një sasi e konsiderueshme kontigjencash, të cilat do të jenë të disponueshme për t'u alokuar në drejtime të ndryshme të ekonomisë në rast se efektet negative të krizës ekonomike do të jenë më të forta se sa janë parashikuar.

Parashikimi i treguesve makroekonomik afatmesëm dhe i tërësisë së elementeve përbërëse të kuadrit makroekonomik është bazuar në teknikat analitike të programimit financiar, në modele ekonometrike të ndërtuara e përdorura për projektimin e variablave apo lidhjeve ekonomike me natyrë specifike, si dhe për module të veçanta të kuadrit është përdorur si një instrument kalibruar modeli “*input – output*” i ngritur në Ministrinë e Financave. Për këtë qëllim janë ndërtuar disa skenarë të mundshëm të ecurisë makroekonomike të vendit, rezultatet e të cilave i janë nënshtruar një analize krahasuese të hollësishme për të arritur në skenarin bazë makroekonomik, i cili prezantohet në këtë seksion. Skenari bazë i kuadrit makroekonomik bazohet në linjën aktuale të politikave makroekonomike, në linjën aktuale të politikave e reformave ekonomiko-strukturale qeveritare, si dhe në sjelljen dhe në bashkëveprimin e natyrshëm e racional të aktorëve ekonomikë brenda kontureve të ambientit të brendshëm e të jashtëm makroekonomik më probabel për periudhën afatmesme në vijim.

Në kryerjen e këtyre parashikimeve është përdorur një set i gjerë të dhënash statistikore makroekonomike të publikuara prej institucioneve, si: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Eurostat, Banka Qendrore Evropiane etj. Këto statistika janë kryesisht në formën e serive kohore me frekuencë vjetore, tremujore e mujore dhe kohëzgjatja e tyre e marrë në konsideratë për ndërtimin e këtij kuadri është përgjithësisht që prej vitit 1996. Pasi ndiqen të gjitha etapat metodologjike të parashikimit, testimi, analizat krahasuese, statike, dinamike e, pasi kryhen një sërë testesh konsistence, skenari bazë i përfutur synon të paraqesë situatën makroekonomike përgjithësisht më të mundshme e maksimalisht konsistente në aspektin e një ekonomie të plotë e integrale.

Ruajta e stabilitetit makroekonomik, mbajtja e normës së inflacionit rreth nivelit 3%, mbajtja e deficitit në norma të ulëta dhe ulja e borxhit publik në përputhje edhe me Kriteret e Mastroitit, si dhe zbutja e deficitit të llogarisë korrente përbëjnë objektivat bazë të politikave të koordinuara monetare e fiskale të vendit. Këto objektiva përbëjnë dhe konturet themelore të këtij kuadri makroekonomik brenda të cilave kryhen projeksionet për të gjithë variablat e tjerë makroekonomik. Në tabelën e mëposhtme paraqiten vlerësimet dhe projeksionet për treguesit kryesorë makroekonomik për periudhën 2006 - 2009.

Tabela 9.
Treguesit kryesorë makroekonomikë

Treguesit	2006	2007	2008	2009
Popullsia (milion banorë)	3.15	3.16	3.17	3.18
PBB nominal (në miliard lekë)	882.2	971.2	1085.7	1176.3
Rritja reale e PBB-së (në %)	5.4	6	8	5.8
PBB nominal për banorë (në mijë lekë)	280.1	307.2	342.7	369.4
PBB nominal për banorë (në USD)	2855.6	3396.7	4085	3827.7
Deflatori i PBB-së	2.7	3.9	3.5	2.4
Inflacioni mesatar vjetor	2.4	2.9	3.4	2.3
Kursi i këmbimit valutor (lekë/euro)	123	123.9	122.8	130
Investimet totale (në % të PBB-së)	39	38,6	40,2	38,7
nga të cilat publike	6.8	6.5	9.5	9.8
Bilanci tregtar (në % të PBB-së)	-23,6	-26,7	-26,7	-25
Bilanci i llogarisë korrente (në % të PBB-së)	-6,6	-10,6	-14,9	-14,6
Bilanci i pagesave (në milion euro)	206. 5	148.6	191.9	-240

2. SHPENZIMET BUXHETORE PËR FËMIJËT

Shpenzimet publike kanë si qëllim të tyre final përmirësimin e nivelit të jetesës së popullsisë në përgjithësi, pa bërë dallime, apo pa u diferencuar për shtresa të ndryshme të saj. Për këtë arsye, për të bërë të mundur një llogaritje të shpenzimeve publike që shkojnë te fëmijët, detyrimisht duhet të bëjmë disa llogaritje duke bërë dhe disa arsyetime logjike, duke u nisur nga praktika e përgjithshme.

Kështu, shpenzime buxhetore që shkojnë te fëmijët janë:

Shpenzimet në sektorin e Arsimit Parauniversitar, i cili përfshin: Arsimin Parashkollor, Arsimin 9-vjeçar, Arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe Arsimin e mesëm profesional, (pa përfshirë zërin “Shpenzime personeli”) shkojnë plotësisht në shërbim të fëmijëve. Këto fonde për vitet 2006 – 2009 dhe ato të planifikuara për vitin 2010, janë:

Tabela 10.
Shpenzimet në sektorin e arsimit parauniversitar

Vitet	Shpenzime të tjera korrente	Investime	Totali
<i>a</i>	<i>b</i>	<i>c</i>	<i>d = b+c</i>
2006	446 486	2 353 304	2 799 790
2007	1 115 556	2 791 562	3 907 118
2008	1 524 500	4 792 454	6 316 954
2009	1 998 600	3 778 994	5 777 594
2010	2 860 000	5 518 194	8 378 194

Shpenzimet në sektorin e shëndetësisë shkojnë në shërbim të gjithë popullsisë dhe, duke përdorur logjikën, se përdorimi i tyre është i njëjtë për të gjitha shtresat e popullsisë, te fëmijët nga ky fond shkon siç është raporti i numrit të fëmijëve ndaj numrit të përgjithshëm të popullsisë. Këto fonde për vitet 2006 – 2009 dhe ato të planifikuara për vitin 2010, janë:

Tabela 11.
Shpenzimet në sektorin e shëndetësisë

Vitet	Shpenzime të tjera korrente (000/leke)	Shpenzime për investime (000/lekë)	Totali (000/lekë)	Nr i fëmijëve / nr total i popullsisë	Buxheti për fëmijët (000/lekë)
<i>a</i>	<i>b</i>	<i>c</i>	<i>d = b + c</i>	<i>e</i>	<i>f = d * e</i>
2006	6 978 129	2 269 998	9 248 127	33,67%	3 113 844
2007	10 555 288	2 451 293	13 006 581	32,88%	4 276 564
2008	11 578 000	3 178 008	14 756 008	32,07%	4 732 252
2009	6 866 112	919 628	7 785 740	33,25%	2 588 985
2010	8 082 400	1 485 128	9 567 528	32,44%	3 104 094

Fonde të alokuara nga MPCSSHB për politikën sociale, të cilat janë: Fondi i ndihmës ekonomike (NE) dhe ai i ndihmës për Personat me Aftësi të Kufizuar (PAK). Për vitet 2009 dhe 2010, qeveria ka shtuar në buxhetin e MPCSSHB edhe një fond për kompensimin e rritjes së çmimit të energjisë elektrike për familjet në nevojë, që janë në përgjithësi ato familje që përfitojnë edhe Ndihmën Ekonomike. Fondet për Ndihmën Ekonomike për vitet 2006 – 2009 dhe ato të planifikuara për vitin 2010, janë:

Tabela 12.
Fonde të alokuara nga MPCSSHB për politikat sociale

Vitet	Ndihma Ekonomike (000/lekë)	Nr i familjeve përfituese	Nr i personave në këto familje	Nr i fëmijëve në këto familje	Buxheti për fëmijët (000/lekë)
a	b	c	$d = c * 4.2$	$e = c * 2.2$	$f = (b / d) * e$
2006	2 800 000	115 000	483 000	253 000	1 466 667
2007	2 600 000	110 000	462 000	242 000	1 361 905
2008	3 300 000	93 000	390 600	204 600	1 728 571
2009	4 534 250	93 000	390 600	204 600	2 375 083
2010	5 200 000	98 000	411 600	215 600	2 723 810

Për llogaritjen e pjesës së buxhetit të PAK-së që shkon për fëmijët përdorim supozimin se edhe në këtë kategori raporti është si ai për gjithë popullsinë. Fondet për Personat me Aftësi të Kufizuar (PAK), për vitet 2006 – 2009 dhe ato të planifikuara për vitin 2010, janë:

Tabela 13.
Fonde të alokuara nga MPÇSSHB për politikat sociale – pjesa për fëmijët

Vitet	Ndihma për PAK (000/lekë)	Nr i përfituesve	Nr i fëmijëve / nr total i popullsisë (%)	Nr i fëmijëve përfitues të PAK	Buxheti për fëmijë (000/lekë)
a	b	c	d	$e = c * d$	$f = b * d$
2006	6 000 000	62 000	33,67%	20 875	2 020 200
2007	7 000 000	64 000	32,88%	21 043	2 301 600
2008	8 600 000	124 000	32,07%	39 767	2 758 020
2009	10 273 000	128 876	33,25%	42 851	3 415 773
2010	11 100 000	131 600	32,44%	42 691	3 600 840

Në shpenzimet buxhetore zëri “Shpenzime personeli”, shpenzime për paga e sigurime, shkon plotësisht në familjet shqiptare. Duke supozuar se raporti i familjeve me punonjësit buxhetorë është 1:1,5, dhe se këto familje kanë mesatarisht 4,2 persona, atëherë mund të llogarisim pjesën e këtij fondi që shkon për fëmijët. Fondet për “Shpenzime personeli”, për vitet 2006 – 2009 dhe ato të planifikuara për vitin 2010, janë sipas tabelës.

Tabela 14.
Fonde të alokuara nga MPÇSSHB për politikat sociale – shpenzime personeli

Vitet	Shpenzime personeli (000/lekë)	Nr i punonjësve buxhetorë	Nr i familjeve	Nr i personave në këto familje	Nr i fëmijëve në këto familje	Buxheti për fëmijët (000/lekë)
A	b	C	$d = c / 1,5$	$e = d * 4.2$	$f = d * 2.2$	$g = (b / e) * f$
2006	56 597 028	107 835	71 890	301 938	158 158	29 646 062
2007	58 970 250	102 209	68 139	286 185	149 907	30 889 179
2008	69 546 550	104 716	69 811	293 205	153 583	36 429 145
2009	59 546 122	90 000	60 000	252 000	132 000	31 190 826
2010	64 625 405	90 000	60 000	252 000	132 000	33 851 403

Në total, nga buxheti qendror sipas llogaritjeve të mësipërme, fondet që kanë shkuar te fëmijët për vitet 2006 – 2009 dhe ato të planifikuara për vitin 2010, janë sipas tabelës.

Tabela 15.
Fonde të alokuara nga buxheti qendror për fëmijët për 2006-2009 dhe plani për 2010

Vitet	Pjesa e buxhetit qendror e llogaritur që shpenzohet për fëmijët (000 lekë)				
	Sektori i Arsimit Parauniversitar	Sektori i Shëndetësisë	Politikat e Mbrojtjes Sociale	Shpenzime Personeli	Totali
<i>a</i>	<i>b</i>	<i>c</i>	<i>d</i>	<i>e</i>	<i>f = b+c+d+e</i>
2006	2 799 790	3 113 844	3 486 867	29 646 062	39 046 563
2007	3 907 118	4 276 564	3 663 505	30 889 179	42 736 365
2008	6 316 954	4 732 252	4 486 591	36 429 145	51 964 942
2009	5 777 594	2 588 985	5 790 856	31 190 826	45 348 261
2010	8 378 194	3 104 094	6 324 650	33 851 403	51 658 340

Duke u krahasuar me buxhetin qendror total fondet që kanë shkuar te fëmijët për vitet 2006 – 2009 dhe ato të planifikuara për vitin 2010, janë:

Tabela 16.
Raporti i buxhetit për fëmijët ndaj buxhetit total, 2006-2009, dhe planifikimi 2010

Vitet	Buxheti në total (000/lekë)	Buxheti për fëmijët (000/lekë)	Raporti i buxhetit për fëmijët me buxhetin total
<i>a</i>	<i>c</i>	<i>b</i>	<i>d = (b / c) %</i>
2006	183 400 198	39 046 563	21,29%
2007	196 171 594	42 736 365	21,79%
2008	239 200 429	51 964 942	21,72%
2009	375 718 000	45 348 261	12,07%
2010	410 720 452	51 658 340	12,58%

Në të njëjtën mënyrë bëjmë llogaritjet për pjesën që shkon te fëmijët nga buxheti vendor (Buxheti i Njësitë të Pushtetit Vendor)

Nga Buxheti për arsimin parauniversitar në Njësitë e Pushtetit Vendor për vitet 2006-2009, për fëmijët shkojnë fondet:

Tabela 17.
Buxheti i pushteti vendor për fëmijët e Arsimit Parauniversitar

Vitet	Shpenzime të tjera korrente	Shpenzime për investime	Totali	Nr. i fëmijëve në shkolla (mosha 6-18 vjeç)
<i>a</i>	<i>b</i>	<i>c</i>	<i>d = b+c</i>	<i>e</i>
2006	1 164	382	1 546	679 753
2007	1 233	195	1 428	644 127
2008	1 926	3 825	5 751	627 509
2009	970	195	1 165	630 000

Nga Buxheti për sektorin e shëndetësisë për Njësitë e Qeverisjes Vendore për vitet 2006-2009, për fëmijët shkojnë fondet:

Tabela 18.
Buxheti për fëmijët nga pushteti vendor për sektorin e shëndetësisë

Vitet	Shpenzime të tjera korrente (000/leke)	shpenzime për investime (000/leke)	Totali (000/lekë)	Nr i fëmijëve/ nr total i popullsisë (%)	Buxheti për fëmijë në total (000/lekë)
<i>a</i>	<i>b</i>	<i>c</i>	<i>d = b + c</i>	<i>e</i>	<i>f = d * e</i>
2006	4	14	18	33.67%	5.99
2007	2	6	8	32.88%	2.56
2008	2	4	6	32.07%	2.02
2009	1	4	5	35.25%	1.66

Numri i punonjësve në pushtetin vendor, **fondet në zërin “Shpenzime personeli”** dhe fondet që shkojnë për fëmijët në vitet 2006-2009.

Tabela 19.

Buxheti për fëmijët nga pushteti vendor në kuadër të fondeve shpenzime personeli

Vitet	Shpenzime personeli (000/leke)	Nr. i punonjësve në njësitë vendore	Nr. i familjeve	Nr. personave në këto familje	Nr. i fëmijëve në këto familje	Buxheti për fëmijët (000/lekë)
<i>a</i>	<i>b</i>	<i>c</i>	$d = c / 1,5$	$e = d * 4.2$	$f = d * 2.2$	$g = (b/e) * f$
2006	6,889	15,600	10,400	65,520	22,880	2,406
2007	7,478	15,700	10,467	65,940	23,027	2,611
2008	8,677	17,000	11,333	71,400	24,933	3,030
2009	9,850	17,850	11,900	74,970	26,180	3,440

Edhe Njësitë e Qeverisjes vendore, nga fondet e tyre japin ndihma ekonomike, por këto fonde janë shumë të pakta, dhe gjithashtu është e pamundur të merret informacion për numrin e familjeve apo të personave përfitues të këtyre fondeve, gjë që e bën të pamundur llogaritjen e pjesës që shkon për fëmijët nga ky fond.

Kështu pjesa e buxhetit të njësisve vendore për fëmijët për vitet 2006-2009, është:

Tabela 20.

Buxheti për fëmijët nga pushteti vendor në total për 2006-2009

Vitet	Buxheti i llogaritur për fëmijët (000 lekë)			
	Spektori i Arsimit Parauniversitar	Spektori i Shëndetësisë	Shpenzime personeli	Totali
<i>a</i>	<i>b</i>	<i>c</i>	<i>d</i>	$e = b + d + c$
2006	1,546	5.99	2,406	3,958
2007	1,428	2.56	2,611	4,042
2008	5,751	2.02	3,030	8,783
2009	1,165	1.66	3,440	4,606

Raporti i buxhetit vendor për fëmijë, ndaj atij total për vitet 2006 – 2009

Tabela 21.

Raporti i buxhetit për fëmijët nga pushteti vendor ndaj buxhetit total

Vitet	Buxheti për fëmijët (000/leke)	Buxheti në total (000/leke)	Raporti i Buxh për fëmijët/ buxhetit total
<i>a</i>	<i>b</i>	<i>c</i>	$d = (c/ b) \%$
2006	183 422 904	39 050 521	21,29%
2007	196 193 867	42 740 407	21,78%
2008	239 222 723	51 973 726	21,73%
2009	375 748 000	45 352 865	12,07%

Në total pjesa e shpenzimeve publike që shkon për fëmijët për vitet 2006-2009

Tabela 22.
Shpenzimet publike totale për fëmijët për 2006-2009

Vitet	Buxheti Qendror + Vendor		
	Total (000 lekë)	Pjesa për fëmijët (000 lekë)	Raporti (% ndaj totalit)
<i>a</i>	<i>b</i>	<i>c</i>	<i>d = (c / b) %</i>
2006	183 422 904	39 050 521	21,29%
2007	196 193 867	42 740 407	21,78%
2008	239 222 723	51 973 726	21,73%
2009	375 748 000	45 352 865	12,07%

Raporti i pjesës së buxhetit që shkon për fëmijët ndaj PBB

Tabela 23.
Raporti i pjesës së buxhetit që shkon për fëmijët ndaj PBB

Vitet	PBB nominale	Buxheti për fëmijët	Raporti (% ndaj PBB)
<i>a</i>	<i>b</i>	<i>c</i>	<i>d = (c / b) %</i>
2006	899 700 000	39 050 521	4,34%
2007	979 000 000	42 740 407	4,37%
2008	1 085 674 000	51 973 726	4,79%
2009	1 176 349 000	45 352 865	3,86%

3. FINANCIMI I POLITIKAVE SOCIALE – ECURIA NË VITE

3.1 Shpenzimet për Arsimin


Arsimi është nga sektorët parësorë në pothuajse të gjitha vendet e zhvilluara dhe të atyre në zhvillim. Arsyeja kryesore e shpenzimeve publike në arsim, është krijimi i një Sistemi Arsimor që të mundësojë arsimin bazë të të gjithë fëmijëve nën moshën 15 vjeç, si dhe të krijojë kushte për një arsim të mesëm dhe universitar cilësor, për të gjithë nxënësit me aftësi dhe dëshirë për arsimim. Historia e zhvillimit të të gjitha vendeve perëndimore ka vërtetuar se investimi në arsim ka qenë faktor përcaktues në zhvillimin ekonomik të vendit nëpërmjet rritjes së produktivitetit të punës, nxitjes së zhvillimit teknologjik dhe shfrytëzimin e përparësive që të krijojnë rritja e hapësirave të tregjeve, kjo është edhe arsyeja kryesore që në vendet perëndimore, shpenzimet publike në arsim, janë në nivele relativisht të larta. Rëndësia e këtij sektori ka qenë arsyeja që raporti merret më hollësisht me analizën e shpenzimeve publike të alokuara për sektorin e arsimit, gjë e cila do të bëhet në kapitullin e mëposhtëm.

3.2 Shpenzimet për mbrojtjen sociale

Shpenzimet për mbrojtjen sociale për familjet me të ardhura të pamjaftueshme dhe pagesat e papunësisë, janë fonde të cilat shprehin funksionin rialokues të buxhetit të shtetit. Sipas figurës 1 vihet re se se këto shpenzime zënë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve buxhetore, të cilat tejkalojnë edhe shpenzimet për arsimin dhe shëndetësinë të marra së bashku, për të gjithë periudhën 10-vjeçare, 1994-2003. Në vitin 1994 këto fonde përbënin 9,58% të PBB-së. Pas

vitit 1997 kemi një rënie relative në raport me PBB-në të këtyre shpenzimeve, dhe pikërisht në 6,77% në vitin 1999, duke arritur në nivelin më të ulët në vitin 2003, ku shpenzimet faktike për mbrojtjen sociale dhe papunësinë ishin sa 6,71% e madhësisë së PBB-së.

Figura nr.1



Në planin e vitit 2004 e atë të vitit 2005, parashikohet një rënie e mëtijshme e këtyre shpenzimeve, përkatësisht në nivelin 6,65% dhe 6,58% të PBB-së. Pavarësisht nga kjo rënie, përsëri shpenzimet për mbrojtjen sociale dhe papunësinë kanë qenë pjesa më e madhe e fondeve buxhetore të alokuara nga buxheti i shtetit, në programin e mbrojtjes sociale.

4. POLITIKAT DHE STRATEGJITË PËR MBROJTJEN SOCIALE NË SHQIPËRI DHE FINANCIMI I TYRE

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (1998), është sanksionuar se republika jonë ka objektiva sociale të lidhur me punësimin, shëndetin, edukimi, pensionet dhe kujdesin social. Në Kushtetutë është përcaktuar se këta objektiva sociale duhet të rregullohen me ligje të veçanta. Procesi i reformave që janë kryer e po vazhdojnë të kryhen nga Qeveritë shqiptare, të mbështetura nga donatorët, si Banka Botërore, Këshilli i Evropës, Organizata Botërore e Punës (ILO), PNUD-i etj. Banka Botërore në veçanti, që është shumë aktive në angazhimin e saj në Shqipëri, me mbështetje të dyfishtë, si atë financiare edhe teknike, vazhdon të mbështesë qeverinë në formulimin e këtyre politikave.

Duke njohur ndryshimet që procesi i integritit evropian ka sjellë në administratën publike shqiptare, si dhe problemet në politikat e zhvillimit dhe koordinimit, Qeveria krijoi në nëntor 2005, Sistemin e Planifikimit të Integruar (SPI), pjesët përbërëse të të cilit janë: (I) procesi i planifikimit strategjik (Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, SKZHI) dhe (II) Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA). SPI ka nxjerrë një grup principesh operative dhe struktura

mbështetëse, të cilat përpiqen të sigurojnë se planifikimi dhe monitorimi i qeverisë, është efikas dhe i harmonizuar. Kjo është mundësuar nga një nën-komitet i qeverisë (Komiteti i Planifikimit Strategjik), i cili mbledhet disa herë gjatë vitit, për të diskutuar dhe zgjidhur problemet e procesit të përgatitjes së buxhetit.

Dokumentet e miratuara strategjike për mbrojtjen dhe përmirësimin e jetesës së fëmijëve janë:

- 1) **Strategjia e mbrojtjes sociale**
- 2) **Strategjia e sigurimeve shoqërore**
- 3) **Strategjia e sektorit të shëndetësisë**
- 4) **Strategjia e përfshirjes sociale**
- 5) **Strategjia e barazisë gjinore dhe parandalimit të dhunës në familje**
- 6) **Strategjia kombëtare për fëmijë dhe Plani kombëtar i veprimit**

4.1 Buxhetimi i politikave sociale

Pas miratimit të ligjit nr 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, është bërë një përpjekje e mirë për përfshirjen e këtyre dokumenteve strategjike në buxhetin e qeverisë shqiptare. Pas miratimit të këtij ligji, me ndryshimin e mënyrës së realizimit, si të procesit të planifikimit, ashtu edhe të implementimit të buxhetit, tashmë ne kemi një mundësi më të madhe të vëzhgimit të realizimit në praktikë të këtyre politikave, nëpërmjet realizimit të objektivave apo dhe produkteve konkrete të planifikuara për t’u realizuar.

Në këtë kuadër është bërë vlerësimi konkret i buxhetimit të këtyre politikave, duke u mbështetur në Programet Buxhetore Afatmesme 2008-2010, 2009-2011 dhe 2010-2012, si dhe buxhetit vjetor 2008, 2009 dhe planit të vitit 2010, për Ministrinë që mbajnë peshën kryesore të zbatimit të politikave të qeverisë në lidhje me fëmijët, në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta dhe Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

Në vijim analizohen programet buxhetore: “Mbrojtja Sociale”, “Tregu i punës” dhe “Mbrojtja sociale” të MPCSSHB dhe “Arsimi Bazë”, “Arsimi i mesëm i përgjithshëm” dhe “Arsimi i mesëm profesional”, të MASH-i.

1. DECENTRALIZIMI

1.1 Koncepte dhe përkufizime

Decentralizimi është procesi i kalimit të vendimmarrjes së qeverisjes sa më afër popullsisë dhe/ose qytetarëve. Përfshin shpërndarjen e administrimit apo qeverisjes në sektorë ose zona si inxhinieria, shkenca e menaxhimit, shkenca politike, politika ekonomike, sociologjia dhe ekonomia. Decentralizimi dhe qeverisja vendore njihen si komponentët bazë të qeverisjes demokratike, meqenëse sigurojnë një mjedis ku vendimmarrja dhe shpërndarja e shërbimeve mund të sillen afër njerëzve, veçanërisht të varfërve.

Në këndvështrimin e nivelit të qeverisjes vendore decentralizimi është procesi i kalimit dhe i delegimit të kompetencave autoriteteve të vendimmarrjes në nivelet më të ultëta për të inkurajuar qytetarët të marrin pjesë veçanërisht në procesin e buxhetimit, relativisht larg dhe në nivele më të ulëta se autoritetet qendrore. Një formë e decentralizuar e vendimmarrjes shfaq më në strukturën organizative të niveleve më të ulëta, hapësirë më të gjerë të kontrollit dhe një rrjedhë vendimmarrjeje nga fundi në krye si dhe rrjedhshmëri idesh.

Përfitimet e decentralizimit mund të përmbliken si më poshtë:

- Autoritetet vendore kanë më shumë hapësirë të veprojnë në përputhje me kërkesat dhe kushtet vendore dhe t'u përgjigjen më shpejtë nevojave vendore. Decentralizimi u jep mundësi sektorëve të marginalizuar të komunitetit, si grave në disa vende, minoriteteve etj. që të marrin pjesë në nivel lokal, duke bërë të mundur një afrim të zbatimit dhe formulimit të politikave.
- Zgjerohen mundësitë për transparencë dhe rritje të përgjegjësisë, sasia e parave e shmangur nga zhvillimi zakonisht bie. Raporti i Zhvillimit Njerëzor (2003)²⁴ – ; decentralizimi i shpenzimeve qeveritare është i lidhur ngushtë me korrupsionin në nivele të ulëta, midis burokratëve dhe ulin shumën duke kërkuar nga palët private – duke lënë më shumë para për t'i shpenzuar për shërbimet bazë për njerëzit e varfër.
- Rritet efektiviteti i shpërndarjes së shërbimeve, sepse të zgjedhurit, duke qenë më afër zgjedhësve, marrin ankesa prej tyre dhe, duke rritur kontrollin mbi veprimtarinë e punonjësve të administratës shtetërore, p.sh., në shkollat vendore dhe klinika shëndetësore, mund të ndikojnë në përmirësimin e disiplinës e të shërbimeve.
- Bëhen programe zhvillimi më të qëndrueshme dhe me kosto efektive, sepse njerëzit e zonave vendore kanë më shumë gjasa të përfshihen në projektimin, ekzekutimin dhe monitorimin e tyre.
- Inkurajohen komunitetet të gjejnë zgjidhje për problemet e tyre të përditshme, duke krijuar ide të reja, të cilat janë më të përshtatshme për kushtet vendore.
- Sigurohen mundësi për të tërhequr më shumë njerëz, duke përfshirë grupet jo të mirëpërfaqësuar (si gratë në disa vende, minoritetet, të varfrit etj.) të marrin pjesë në vendimmarrje, të cilat prekin jetën e tyre.

24 UNDP, Human Development Report – 2003, “Millennium Development Goals: A compact among nations to end human poverty”, UN, NY, 2003.

Për të përmbledhur, për shkak të një shkalle më të lartë përgjegjësie, reagimi dhe pjesëmarrjeje, decentralizimi efektiv mund të bëjë një ndryshim të madh duke siguruar shërbime vendore (sociale dhe ekonomike) më të frytshme, të paanshëm, të qëndrueshëm dhe me kosto më të leverdishme. Me anë të pjesëmarrjes së komunitetit në vendimmarrje në planifikim, zbatim dhe monitorim dhe, të mbështetur nga institucionet dhe me burime të përshtatshme, mund të përmirësohet më shpejt cilësia e jetesës, veçanërisht e të varfërve dhe sektorëve të margjinalizuar të popullsisë, rrjedhimisht duke lehtësuar varfërinë.

1.2. KATEGORITË E DECENTRALIZIMIT DHE QEVERISJA VENDORE

Decentralizimi — transferimi i autoritetit dhe përgjegjësi për funksionet publike nga qeveria qendrore drejt organizatave qeverisëse vartëse ose pothuajse të pavarura dhe/ose sektorit privat — është një koncept kompleks dhe i gjithanshëm. Përfshin një shumëllojshmëri konceptesh. Lloje të ndryshme të decentralizimit paraqesin karakteristika të ndryshme, përzierje politikash dhe kushte për sukses.

Për një konsolidim efektiv të qeverisë vendore, decentralizimi konsiderohet, si: (i) decentralizim politik, duke synuar t'u japë qytetarëve dhe përfaqësuesve të zgjedhur më shumë fuqi në procesin publik të vendimmarrjes; (ii) decentralizim administrativ, duke përfaqësuar rishpërndarje të autoritetit, përgjegjësi dhe aftësi për të siguruar shërbime publike përmes niveleve të ndryshme të qeverisjes dhe (iii) decentralizim fiskal, me anë të të cilit njësitë e qeverisjes vendore kanë të ardhurat e duhura, të vetat apo të transferuara nga qeveria qendrore, për të realizuar funksionet e tyre të decentralizuara, si dhe autoritetin për të marrë vendime për të shpenzuar.

1.2.1 Decentralizimi politik

Decentralizimi politik ka për qëllim t'u japë qytetarëve apo përfaqësuesve të zgjedhur fuqinë në vendimmarrjen publike. Zakonisht është i lidhur me politikën pluraliste dhe qeverinë përfaqësuese, por edhe mund të mbështesë demokratizimin duke u dhënë qytetarëve ose përfaqësuesve të tyre më shumë ndikim në formulimin dhe zbatimin e politikave. Avokatët e decentralizimit politik supozojnë se vendimet e marra me pjesëmarrje më të gjerë do të jenë më të mirëinformuara dhe më të përshtatshme për të paraqitur interesat në shoqëri, se sa ato të marra nga autoritetet politike kombëtare. Koncepti nënkupton se zgjedhja e përfaqësuesve nëpërmjet zgjedhjeve elektorale vendore lejon qytetarët të njohin më mirë përfaqësuesit e tyre politikë dhe lejon zyrtarët e zgjedhur të njohin më mirë nevojat dhe dëshirat e zgjedhësve të tyre. Decentralizimi politik zakonisht kërkon reforma ligjore ose kushtetuese, krijimin e njësisve politike vendore dhe inkurajimin e grupeve me interesa publikë.

1.2.2 Decentralizimi administrativ

Decentralizimi administrativ kërkon të rishpërndajë autoritetin, përgjegjësinë dhe burimet financiare për sigurimin e shërbimeve publike nga një nivel më i lartë, në një më të ulët të qeverisjes. Është transferimi i përgjegjësi për planifikimin, financimin dhe menaxhimin e funksioneve publike nga qeveria qendrore ose qeveritë rajonale dhe agjencitë e tyre drejt qeverive vendore, autoritete apo korporata publike gjysmë-autonome ose autoritete rajonale apo funksionale të zonave të gjera.

Dekoncentrimi - Dekoncentrimi është forma më e dobët e decentralizimit dhe përdoret më shpesh në shtetet unitare – rishpërndan autoritetin vendimmarrës dhe përgjegjësinë menaxhuese midis niveleve të ndryshme të qeverisjes kombëtare. Mund të zhvendosë përgjegjësitë nga zyrtarët e qeverisjes qendrore në kryeqytet drejt atyre që punojnë në rajone, provinca, rrethe ose mund të krijojë një fushë të fortë administrimi apo kapacitete administrative vendore nën supervizionin e ministrive të qeverisjes qendrore.

Delegimi - Kjo është një formë më e gjerë e decentralizimit. Nëpërmjet delegimit qeveria qendrore transferon përgjegjësinë për vendimmarrje dhe administrimin e funksioneve publike drejt organizatave gjysmë-autonome, jo totalisht të kontrolluara nga qeverisja qendrore, por i përgjigjet asaj. Qeveritë delegojnë përgjegjësitë, kur krijojnë ndërmarrje ose korporata publike, autoritete strehimi, autoritete të transportit, rrethe të shërbimeve speciale, rrethe shkollore gjysmë-autonome, korporata të zhvillimit rajonal ose njësi të zbatimit të projekteve speciale. Zakonisht këto organizata kanë marrëveshje për liri veprimi në vendimmarrje. Ato mund të lirohen nga kufizimet e personelit të shërbimit të rregullt civil dhe mund të punësojnë drejtpërdrejtë përdorues për shërbim.

Transferimi - Është një lloj i decentralizimit administrativ. Kur qeveria transferon funksione, ato transferojnë autoritetin për vendimmarrje, financim dhe menaxhim të njësive pothuajse autonome të qeverisjes vendore me status korporate. Transferimi zakonisht kalon përgjegjësinë për shërbime në qeveritë vendore që zgjedhin vetë funksionarët dhe këshilltarët, rrisin pagat e tyre dhe kanë autoritetin e pavarur për të marrë vendime investimi. Në një sistem të transferuar, qeveritë vendore kanë kufij të qartë dhe të njohur gjeografikë mbi të cilët ushtrojnë autoritetin e tyre dhe brenda të cilëve kryejnë funksionet publike.

1.2.3 Decentralizimi fiskal

Shpërndarja e përgjegjësiave financiare është një komponent bazë i decentralizimit. Nëse qeveritë vendore dhe organizatat private duan të zbatojnë funksione efektive të decentralizuara, ato duhet të kenë një nivel të përshtatshëm të të ardhurave – të ngritura lokalisht ose të transferuara nga qeveria qendrore – si dhe autoritetin për të marrë vendime për shpenzimet. Decentralizimi fiskal mund të marrë shumë forma, përfshirë këtu:

- vetëfinancim ose rikuperim i kostove nëpërmjet tarifave të shfrytëzimit,
- marrëveshje bashkëfinancimi ose bashkëprodhimi, nëpërmjet të cilave përdoruesit marrin pjesë duke siguruar shërbime dhe infrastrukturë nëpërmjet kontributeve monetare ose fuqisë punëtore;
- zgjerim i të ardhurave vendore nëpërmjet taksave të pronës, të shitjes ose të pagesave jo të drejtpërdrejta;
- transferta ndërqeveritare, të cilat zhvendosin të ardhurat e përgjithshme nga taksat e mbledhura nga qeveria qendrore drejt qeverive vendore për përdorime të përgjithshme ose specifike;
- autorizim për huamarrje vendore dhe mobilizimi të burimeve vendore ose kombëtare nëpërmjet garancive të kredisë.

Në shumë vende në zhvillim qeveritë vendore ose njësitë administrative zotërojnë autoritetin ligjor të vendosin taksa, por baza e taksës është kaq e ulët dhe varësia nga qeveria qendrore subvencionohet aq ngurtësisht, sa që nuk bëhet asnjë përpjekje për të ushtruar këtë autoritet.

1.3 SHQIPËRIA DHE PROCESI I DECENTRALIZIMIT

Procesi i decentralizimit do të vazhdojë të konsiderohet si një instrument dhe tregues i qartë i dëshirës së shoqërisë shqiptare, aktorëve të rëndësishëm të jetës politike dhe administrative, veçanërisht të qeverisë për : (i) ngritjen e një sistemi demokratik; (ii) sigurimin e një qeverisjeje të mirë dhe efektive për qytetarët; (iii) ushtrimin e fuqisë dhe shpërndarjes së shërbimeve në një nivel sa më afër qytetarëve; (iv) tërheqjen dhe sigurimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendim-marrje; dhe (v) kontribimin në mënyrë aktive në procesin e integritimit nëpërmjet korporatave ndërkufitare, ndërkomunale dhe ndërrajonale.

Decentralizimi në Shqipëri bazohet në dokumentet kryesore evropiane për demokracinë vendore dhe rajonale, Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore, të Këshillit të Evropës, strukturat e konventave për korporatat ndër-kufitare, Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në të gjithë kuadrin ligjor për qeverisjen vendore.

Ndonëse Shqipërisë ende i mungon përfundimi i dizenjimit të decentralizimit fiskal dhe administrativ, që do të sjellë përmirësim shumë të kënaqshëm në shpërndarjen e shërbimeve, në qeverisje dhe përgjegjësi, duhet të pranohet se është bërë progres i konsiderueshëm në krijimin e institucioneve bazë dhe në kuadrin ligjor, si edhe në zbatimin e politikave për decentralizimin. Që nga viti 2000 janë rregulluar shumë marrëveshje të rëndësishme institucionale, janë miratuar shumë rregullore dhe janë zbatuar në shumë fronte reformat e politikave fillestare.

Procesi i decentralizimit, si shumë procese të tjera të rëndësishme, që ndikojnë në qeverisjen e përgjithshme, duhet të shkojë në përputhje me dokumentet strategjike dhe prioritetet e theksuara në to, një prej të cilave mund të jetë SKZHI. Po të flasim në terma më konkretë, në përgjithësi procesi i decentralizimit duhet të ndjekë drejtime strategjike, si:

- **Transferim i shpejtë i prioriteteve në qeverisjen vendore.** Transferimi i plotë i pronësisë në qeveritë vendore është ende në proces dhe i papërfunduar për shkak të vështirësive ligjore dhe procesit të legalizimit ende të papërfunduar në të gjithë vendin.
- **Përmirësimi i bashkëveprimeve për kompetenca të përbashkëta.** Në lidhje me përmbushjen e detyrave në fushën e arsimit dhe shëndetësisë, nevojitet një rregullore e veçantë në lidhje me dispozitat e Kartës dhe ligjit organik të qeverisjes vendore ku të cilësohen me qartësi përgjegjësitë e secilit aktor dhe mënyra e koordinimit midis tyre duke qartësuar pozicionin e çdo njësie të qeverisjes vendore.
- **Përmirësimi i ndarjes administrative-territoriale.** Është shumë e rëndësishme që në këtë fazë të përdoren instrumente efektive që zgjerojnë bashkëpunimin ndërkomunal, duke pasur bashkëpunim midis bashkive dhe komunave për sigurimin e shërbimeve publike.

1.4 NDARJA TERRITORIALE E SHQIPËRISË

Edhe pse Shqipëria është një vend i vogël, territori i saj është i ndarë zyrtarisht në 374 njësi vetëqeverisëse vendore të nivelit të parë (65 bashki dhe 309 komuna). Ashtu si shumë vende të tjera evropiane në tranzicion, kjo ndarje ngre shqetësime, të cilat shkojnë përtej argumenteve të efikasitetit ekonomik (p.sh., ekonomitë e shkallës dhe eksternalitetet) për të përfshirë konsiderata të një natyre politike dhe administrative.

Ka argumente pro dhe kundër: ndarje do të thotë që vendimmarrësit të jenë më afër votuesve, gjë që rrit përfaqësimin demokratik dhe në varësi të projektimit të fuqive dhe stimujve të decentralizimit mund të rritë përgjegjësinë politike, ndërkohë që në anën tjetër, copëzimi i tepruar

tenton të lërë komunitetet më të vogla pa burime financiare dhe pa kapacitete administrative dhe teknike të nevojshme për të zbatuar politika efikase dhe për të vënë në funksion shërbime publike të efektshme — një argument i cili shkon kundër decentralizimit.

Tabela 24.
Shpërndarja rajonale në Shqipëri

Rajonet	Popullsia	Sipërfaqe (km ²)	Banorë/m ²
Berat	266 401	1665, 4	159, 96
Dibër	225 800	2373, 1	95, 14
Durrës	352 673	704, 7	500, 45
Elbasan	437 087	3251, 2	134, 43
Fier	480 589	1739, 5	276, 27
Gjirokastrë	168 879	2902, 2	58, 18
Korçë	357 915	3503, 2	102, 16
Lezhë	209 584	1514, 4	138, 39
Kukës	140 437	2479, 1	56, 64
Shkodër	337 194	3184, 2	105, 89
Tiranë	829 885	1645, 9	504, 21
Vlorë	341 100	2719, 5	125, 42
TOTAL	4 147 544	27682, 4	148, 82

Burimi: INSTAT 2005

1.4.1 Vlerësim i përgjithshëm i ndarjes rajonale

Ka opinione pro dhe kundër në lidhje me ndarjen territoriale, të cilat do të përmbliidhen në seksionin pasardhës në termat e funksionalitetit dhe fondeve të shpërndara. Përmbledhtazi, funksioni kryesor i rajoneve është të bashkërendojë planifikimin dhe zhvillimin midis disa zonave në mënyrë që bashkitë/komunat të mund të përfitojnë nga ekonomitë e shkallës dhe nga efikasiteti i zgjeruar në dispozitën e shërbimeve.

Për këshillat rajonale ligji caktoi funksionet ekskluzive të planifikimit dhe koordinimit të veprimeve me interes rajonal dhe të shpërndarjes së shërbimeve publike që mund të delegohet nga qeveria qendrore ose bashkitë apo komunat e zgjedhura. Rrethi ka të drejtën të përgatisë dhe të zbatojë programet e zhvillimit rajonal. Sipas kësaj strukture, me ndihmën e ekspertëve ndërkombëtarë, përgatiten dhe miratohen strategjitë për zhvillim rajonal në të gjitha rrethet. Objektivat kryesorë të këtyre strategjive janë të fokusuar në përgatitjen e strukturës për një zhvillim të qëndrueshëm dhe përmirësimin të cilësisë së jetesës së komunitetit, si dhe të reduktimit të varfërisë, zgjerimit të arsimit, përmirësimin të sistemit të shëndetësisë, zhvillimit të SME-ve dhe sigurimit të një mjedisi të begatë dhe qeverisjeje të mirë.

Në thelb rrethi është krijuar që të realizojë përdorimin e burimeve në ata sektorë ku efikasiteti mund të arrihet nga ekonomitë e shkallës. Funksioni vendimtar i rrethit, si njësi dytësore e qeverisjes vendore është përgatitja dhe zbatimi i politikave dhe programeve rajonale, supervizimi i programeve përmes sektorëve dhe harmonizimi i tyre me politikat shtetërore.

Megjithatë, në praktikë, koncepti i qeverisjes vendore rajonale perceptohet ende si një “kuti bosh”, pasi, përderisa funksionet e këshillave rajonale janë ende të papërcaktuara mirë, këshillat nuk mund të mbështeten në autonominë fiskale dhe qeveria qendrore si dhe qeveritë vendore të nivelit të parë ngurrojnë të delegojnë funksione në këshillat. Në fakt, meqë anëtarët e këshillit

rajonal nuk zgjidhen nga qytetarët në rajon, zakonisht mungon llogaridhënia dhe Prefekti (që emërohet nga qeveria qendrore me Kryetarin e Komunës (të cilët dhe zgjidhen drejtpërdrejtë nga bashkitë dhe komunat) kanë vënë në pikëpyetje legjitimitetin e autoriteteve rajonale. Kryetarët e komunave, veçanërisht të komunave të mëdha, janë të gatshëm të pranojnë udhëzime rajonale ose ndërmjetësime në dialogimet e tyre me autoritetet qendrore, pasi ata janë të aftë të mbledhin një audiencë të madhe.

2. FUNKSIONET E PUSHTETIT VENDOR

2.1. ANALIZA DHE VËZHGIME

Ligji i ri i qeverisjes vendore (ligji nr. 8652, datë 31.07.2000) ka caktuar gjerësisht përgjegjësitë e niveleve të qeverisjes duke shoqëruar përgjegjësitë me zonën e përfitimit: qeverisja vendore siguron shërbime që i sjellin dobi juridiksionit vendor, ndërkohë qeverisja qendrore siguron shërbime ku zona përfituese është ajo kombëtare (si politikat monetare, mbrojtja kombëtare, planifikimi dhe zhvillimi i përgjithshëm, çështjet që lidhen me tregtinë e jashtme, drejtësinë dhe sigurinë).

Në parim, ligji u cakton përgjegjësi të përgjithshme qeverive vendore të nivelit të parë (bashki dhe komuna) dhe të nivelin e dytë (rajonet) sipas tri kategorive të funksioneve publike: funksione ekskluzive, të përbashkëta dhe të deleguara.

- *Funksionet ekskluzive:* janë funksione të qeverisjes vendore, të cilat kanë tërësisht në kompetencën e tyre procesin e vendimmarrjes, përgjegjësi dhe financohen nëpërmjet të ardhurave vendore (taksat, tarifet etj.). Në të njëjtën kohë përfituesi kryesor është komuniteti, i cili merr shërbimet publike.
- *Funksionet e përbashkëta:* janë ato funksione që shumica e eksternaliteteve (si p.sh., zona përfituese ka të ngjarë të zgjerohet përtej juridiksionit përkatës) dhe/ose ekonomitë e shkallës ndodhin në ofrimin e shërbimeve vendore. Në këtë rast, kompetencat specifike në funksionet e përbashkëta supozohen të caktohen në mënyrë përzgjedhëse, sipas kapaciteteve dhe interesave të autoriteteve vendore. Kuptohet se, në varësi të funksionit, disa funksione specifike duhet të kryhen nga qeveritë vendore (p.sh., rregullore specifike vendore, financime, shpërndarja e shërbimeve, mirëmbajtja, funksionimi dhe/ose zgjerimi i objekteve), ndërkohë që të tjerat duhet të kryhen nga shteti (p.sh., formulimi i politikave kombëtare; vendosja e standardeve dhe rregulloreve të përgjithshme; financime, monitorime, kontrolle dhe vlerësimi i rezultateve të politikave).
- *Funksionet e deleguara:* Ligji organik për qeverisjen vendore përcakton gjerësisht arsimin parashkollor, kujdesin emergjent/parësor shëndetësor, mbrojtjen e shëndetit publik, ndihmën sociale dhe për zbatimin e buxhetit të udhëzuar (me sa duket i përkohshëm) se “zjarrfikësit dhe policia e shpëtimit të transferohen në autoritetin e prefekturave”. Për shkak të ekonomive të shkallës dhe eksternaliteteve, arsimiti universitar dhe qendrat kërkimore konsiderohen si funksione shtetërore.

Përgjegjësitë për spitalet dhe klinikat e specializuara dhe pjesa tjetër e sektorit të shëndetit (duke përfshirë luftën ndaj HIV, sëmundjet ngjitëse) mbeten funksione shtetërore të de-koncentruara, zbutja e varfërisë, rendi publik, mbrojtja civile dhe mbrojtja e mjedisit si funksione kryesore të

përbashkëta, por me asnjë specifikim të qartë të kompetencave të niveleve qeverisëse. Deri më sot, për shkak të mungesës së mirëpërcaktimit të përgjegjësive, kompetencat e këshillit të vjetër të Qarkut ose janë zhvendosur në prefektura (me sa duket përkohësisht) ose vazhdojnë të kryhen nga agjencitë e dekoncentruara të ministrive të shtrira në territor. Megjithatë, në mënyrë që të shmanget konkurrenca ndërmjet autoriteteve dhe ngatërrimi i përgjegjësive, kompetencat e qeverive vendore duhet të përcaktohen ligjërisht dhe të zbatohen urgjentisht.

2.1.1 Përgjegjësitë dhe funksionet sipas fushave të shëndetësisë, arsimit dhe mbrojtjes sociale

Pavarësisht faktit se zbatimi i Strategjisë Kombëtare për fëmijët perceptohet si një detyrim ligjor i strukturave në nivelin e qeverisjes qendrore, nën procesin e decentralizimit edhe qeverisja vendore përfshihet në institucionalizimin e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri. Organet e administratës së qeverisjes vendore po ndërmarrin dhe zbatojnë hap pas hapi përgjegjësitë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Strukturat përgjegjëse janë: Drejtoritë e Arsimit Rajonal, Drejtoritë e Shërbimeve Sociale, Drejtoritë e Politikave Rajonale dhe njësitë e qeverisjes vendore (bashkitë/rrethet).

Kuadri i ri ligjor rregullator shoqërohet nga efekte të ndryshme, ndërsa zbatimi në praktikë, në terma të zhvendosjes së përgjegjësive. Qëllimi kryesor është të bëhet një ndarje dhe transferim i përgjegjësive nën një bazë racionale që ka si qëllim dobinë e shpërndarjes së burimeve dhe sigurimin me shërbime publike. Është versioni i fundit i **Rishikimit dhe ri-caktimit** të funksioneve të deleguara. Ky proces paraqitet në Tabelën 2 dhe kryhet duke marrë në konsideratë (i) duke ndryshuar ligjin organik me anë të ricaktimit të funksioneve ku zona përfituese është ajo kombëtare, siç është shërbimi veterinar, disa shërbime kombëtare të kujdesit shëndetësor, ndihma sociale për të varfrit (p.sh., ndihma ekonomike), nga funksionet e përbashkëta drejt atyre të deleguara (shikoni paragrafin e mësipërm); dhe (ii) duke përcaktuar kompetencat specifike të qeverisjes vendore në arsim dhe shëndetësi (duke përfshirë funksionet dhe mirëmbajtjen e objekteve) dhe duke i ricaktuar (aktualisht të përkohshme) nga funksione të deleguara në funksione të përbashkëta, siç është autorizuar nga ligji organik.

2.2. SHPËRNDARJA E FONDEVE NËPËR RAJONE – ZHVILLIMET E FUNDIT

Në Shqipëri rajoneve u mungojnë burimet nga të ardhurat e veta. Aktualisht financohen kryesisht nga qeveria qendrore dhe qeveritë vendore. Nga qeveria qendrore marrin grantet e kushtëzuara dhe një pjesë të transfertave të pakushtëzuara dhe nga qeveritë vendore dhe këshillat rajonale supozohet të marrin një përqindje (përgjithësisht 4 për qind) të të ardhurave të veta nga njësia e vetëqeverisjes sipas juridiksionit rajonal, ndonëse në disa bashki (p.sh., Tirana) kanë ngurruar të kontribuojë në pjesën e tyre.

Maksimizimi i mbledhjes së të ardhurave të veta vendore është kritik për autoritetet vendore për sigurimin e mjeteve të nevojshme për të përmbushur përgjegjësitë e tyre në shpërndarjen e shërbimeve publike dhe për zbutjen e barrës në buxhetin e shtetit.

Tema e dytë e vështirë është nevoja për të trajtuar pabarazitë rajonale dhe pabarazitë në ofrimin e shërbimeve publike. Shqipëria ka një sistem të decentralizuar të shpërndarjes së shërbimeve, e cila ndryshon në strukturë nga sektori në sektor. Megjithatë, deri në vitet 2007 - 2008 një problem i përbashkët në të gjithë sektorët ka qenë mungesa e kriterëve objektive për shpërndarjen e burimeve në qeveritë vendore, në institucione dhe siguruesit e shërbimeve. Shpërndarja e investimeve në

njësitë e qeverisjes vendore zakonisht bazohet në disa kritere dhe negocime jotransparente dhe që i shërbejnë shumë pak, për të mos thënë fare, varfërisë apo rritjes ekonomike.

Në shumë raste, shpërndarja e financimeve për shpenzime korrente bazohet në inpute ose norma tradicionale dhe nuk janë të lidhura me rezultatet e parashikuara, nevojat vendore ose me modele aktuale të përdorimit të burimeve. Ato as nuk u përgjigjen nevojave vendore, as nuk krijojnë stimujt e duhur për përdorim efikas të burimeve. Për më tepër, kur burimet transferohen, ka shumë pak kontroll dhe mbikëqyrje në shpenzimet e qeverive vendore.

Fondet shpërndahen kryesisht të bazuara në rëndësinë politike dhe numrin e popullsisë së rretheve. Fatkeqësisht kjo mospërputhje e shpërndarjes së fondeve midis rretheve ka pasur efekte negative në shpërndarjen e fondeve sipas sektorëve.

Në sektorin e arsimit, ndryshimet e mëdha në rezultatet e rajoneve mund të gjurmohen nga diferencat në shpenzimet për frymë. Për shembull, në arsimin e përgjithshëm sekondar, rajoni i cili financohet më mirë, shpenzon një shumë për student tri herë më të madhe nga sa shpenzon rajoni i financuar më keq.

2.2.1 Zhvillimet e fundit

Shqipëria ka treguar progres në projektimin dhe zbatimin e transfertave/granteve, mekanizma këto për të kompensuar pabarazitë fiskale dhe eksternalitetet. Që në fillimin e viteve 1990, këto mekanizma kanë evoluar nga një sistem i i parashikuar vetëm me grante të kushtëzuara (ku qeveritë vendore luanin rolin e agjentëve të qeverisë qendrore në shpërndarjen e shërbimeve publike vendore), drejt një sistemi të përzier me grante “të kushtëzuara” dhe “të pakushtëzuara” — kjo e fundit ishte paraprirë nga një sistem i “granteve bllok” (midis 1999 dhe 2001), i përdorur për të shpërndarë funksione dhe për të mirëmbajtur shpenzimet në sektorët e shëndetësisë, arsimit, punëve publike dhe atyre kulturore.


Mekanismi i “granteve të kushtëzuara” mban ende karakteristikat e vjetra të të qenit jotransparent, i paparashikueshëm dhe i bazuar kryesisht në kompetencat negociuese të autoriteteve vendore dhe ministrive të linjës. Mekanismi i “granteve të pakushtëzuara” u nis me një formulë provizore për shpërndarje, e bazuar në nevoja të ndryshme vendore dhe ende po zhvillohet duke shkuar drejt një transferte të barabartë.

Ka një zhvillim të ri pozitiv në këtë drejtim për vitin 2009. Shpërndarja e fondeve është kryer në bazë të një formule të re, e cila përfshin disa faktorë të rinj, si:

- Popullsia (28 %)
- Treguesi gjeografik (30 %)
- Koeficienti i rrugëve (32 %)
- Shuma fikse (10 %)

Kjo formulë e re merr në konsideratë shumë faktorë që tentojnë të zvogëlojnë pabarazitë rajonale të pranishme deri tani dhe të bëjnë progres drejt faktorit të barazisë. Duke iu referuar formulës së re, fondi i shpërndarë për rajonin e Dibrës është 521 lek për banor, ndërkohë që për rajonin e Tiranës është 80 lekë për banor dhe për Durrësin është 176 lekë për banor. Në vitet e kaluara këto shifra ishin totalisht të ndryshme.

Figura 2 : Shpërndarja e fondeve sipas rretheve



2.3. ANALIZË CILËSORE DHE SASIORE PËR RAJONE SPECIFIKE

Sipas shpërndarjes së fondeve të fundit, siç është treguar edhe në grafikun më sipër, ka një përmirësim në drejtim të parimit të barazisë midis rajoneve, kështu që rajonet më të varfra mund të përfitojnë dhe të trajtohen me drejtësi.

Le të analizojmë në më shumë detaje dy rajone, rajonin e Elbasanit, i cili është një nga rajonet që merr fondet më të larta nga totali dhe rajonin e Kukësit, i cili merr fonde mesatare. Do të mundohemi të shpjegojmë vlerësimin e shërbimeve publike të siguruar për këto rajone dhe efektshmërinë e fondeve të shpërndara.

2.3.1. Rajoni i Kukësit

Ky rajon u zgjodh për një vëzhgim më të detajuar, sepse është rajoni më i vogël në terma të popullsisë dhe, duke parë nga e kaluara, ky rajon ka marrë edhe sasinë më të vogël të fondeve. Tani, sipas formulës së re, ky rajon është i pesti në terma të fondeve të shpërndara dhe kjo sepse merren në konsideratë edhe kritere të tjera si pozicioni gjeografik etj. Në fakt duke pasur parasysh natyrën malore dhe kushtet infrastrukturore, është më i vështirë dhe më i kushtueshëm sigurimi me shërbime publike, si: shkolla publike, kujdes shëndetësor, qendra për kujdes social etj. Kështu, nëse bëjmë një llogaritje të shpenzimeve publike për frymë, në këtë rajon parashikohet që kjo shifër të jetë më e lartë se në rajonet e tjera, të cilat kanë kushte më të mira infrastrukturore dhe pozicion gjeografik më të mirë.

Në rajonin e Kukësit ka 30 510 fëmijë (përafërsisht $\frac{1}{4}$ e popullsisë). Ky është një rajon përgjithësisht i varfër duke konsideruar faktin se 43% e popullsisë jetojnë me ndihmë sociale. Vetëm në bashkinë e Kukësit janë të regjistruar 470 fëmijë të grupmoshës 0-18, nga të cilët 350 janë të ekspozuar ndaj riskut për trafikim, abuzim dhe 397 janë të një risku mesatar.

Një tjetër çështje është e lidhur me punën e fëmijëve, ku në shumë raste janë vetë prindërit që inkurajojnë fëmijët të punojnë, si: shitës ambulante, bujqësi dhe punë të tjera, deri në lypje. Shumë shpesh ky shfrytëzim i fëmijëve nuk trajtohet seriozisht nga institucionet përkatëse.

Gjithashtu, edhe migrimi sezonal i fëmijëve është një tjetër çështje aktuale në këtë rajon. Shumë familje nga komuniteti rom, veçanërisht nga Fushë-Kruja, migrojnë dhe jetojnë në zonat periferike të Kukësit me qëllimin që të çojnë fëmijët për të lypur në Kosovë. Kjo rrjedhje e

pakontrolluar dhe ky abuzim i pakontrolluar i fëmijëve ndikon negativisht në procesin e rritjes së fëmijëve dhe në pjesëmarrjen e tyre në shkollë.

Analizat e treguesve të kujdesit shëndetësor në këtë rajon, të cilat janë nën mesataren e të gjithë vendit, nxjerrin në pah disa probleme kritike, siç janë: mungesa e higjienës, kontrolle periodike të pamjaftueshme dhe cilësi e dobët e sistemit të kujdesit shëndetësor në përgjithësi.

Treguesit e arsimit shfaqin progres, i cili është i krahasueshëm me progresin e të gjithë vendit, por në shumë zona të rajonit të Kukësit ende ka mungesa të kushteve për arsim cilësor, të infrastrukturës dhe aktiviteteve të përshtatshme që ndikojnë në mirërritjen dhe zbatimjen e fëmijëve.

2.3.2. Rajoni i Elbasanit

Numri i fëmijëve në këtë rajon është rreth 140 000, nga të cilët 3200 konsiderohen të jenë përjashtuar nga jeta e komunitetit. Në nivel rajonal, janë 1852 fëmijë që jetojnë me një prind dhe 175 të tjerë të cilët janë pa prindër. Sipas të dhënave statistikore, janë 167 fëmijë, të cilët kanë braktisur shkollën dhe shtyhen të jetojnë në rrugë, të punojnë dhe të rrezikohen nga trafikimi.

Në rajonin e Elbasanit ka një komunitet të madh rom, pjesës më të madhe të fëmijëve të cilit i mungon mbrojtja. Kushtet e jetesës nuk janë të përshtatshme për rritjen normale të fëmijëve në këtë vend. Veçanërisht ky grup fëmijësh vuan dhunën në familje, braktisjen e prindërve etj. Rajoni i Elbasanit, si një rajon me një numër të madh popullsie, ka vuajtur pasojat negative të zhvendosjes së pakontrolluar të njerëzve, që ka sjellë ndryshim të shpeshtë të vendit të jetesës, frekuentim jo të rregullt të shollës nga fëmijët dhe të dhëna jo të sakta për fëmijët që ndjekin shkollën fillore.

Shumica e investimeve në të shkuarën në fushën e arsimit është përqendruar më tepër në rikonstruksionin e ndërtesave të shkollave, i cili është faktor shumë i rëndësishëm në ecurinë e procesit të mësimdhënies. Por ky përqendrim në investimet kapitale kaloi në plan të dytë aspekte të tjera thelbësore, të lidhura me cilësinë e mësimdhënies, kualifikimet e mësuesve, administrimin e shkollave dhe burimet natyrore.

Sipas këtyre problematikave, është shumë e rëndësishme për këtë rajon të ketë një studim të plotë të të dhënave të sakta të bazuara në tregues, si: norma e lindshmërisë dhe faktorë të tjerë që ndikojnë në numrin e nxënësve. Këto të dhëna janë të rëndësishme për t'u lidhur me projektet e investimeve kapitale, si: vendosja gjeografike e shkollave të ardhshme, cilat shkolla do të zgjerohen dhe cilat do të rikonstruktohen, si do të organizohet ndarja optimale e burimeve njerëzore dhe cilat do të jenë nevojat e tyre për kualifikime të mëtejshme, si do të shpërndahen me efektshmëri fondet e qeverive vendore etj. Në sektorin e shëndetësisë, problemet kryesore të këtij rajoni janë të ngjashme me problemet në nivel kombëtar, ku më kryesoret janë: zgjerimi i kujdesit shëndetësor parësor në gjitha zonat rurale, kujdes shëndetësor veçanërisht për të sapolindurit dhe nënat.

Problem i veçantë në këtë rajon është shkalla e lartë e vdekshmërisë tek të sapolindurit, gjë që lidhet me kushtet jo të përshtatshme të jetesës, mungesën e kujdesit shëndetësor parësor në zonat e thella rurale etj. Për shkak të migrimit të popullsisë nga një zonë rurale në një tjetër rurale ose urbane, përsëri ka nevojë për saktësim të dhënash për kërkesat e popullsisë për kujdes shëndetësor parësor, sepse ato ndryshojnë, në mënyrë që të skicohet një hartë për të përcaktuar se cilat zona të reja kanë nevojë për qendra të kujdesit shëndetësor dhe personel të përshtatshëm.

3. FUNKSIONET SIPAS FUSHAVE TË INTERESIT – NIVELI RAJONAL

3.1. Arsimi parauniversitar

Në nivelet vendore, administrimi rajonal ka përgjegjësinë për shpërndarjen e arsimit bazë dhe sekondar (arsimi parashkollor, primar dhe sekondar) në rrethet e tyre duke përfshirë: emërimin dhe transferimin e stafit pedagogjik dhe jopedagogjik, për supervizionin dhe inspektimin e shkollave, dhe për trajnimin e mësuesve. Gjithashtu u përfshi në zonë edhe pajisja e shkollave me materialet e nevojshme administrative (regjistra për nxënësit, dëftesa etj.), mobilie dhe pajime laboratorike, si dhe planifikimi dhe supervizioni i investimeve të bëra në arsim në nivel rrethi, duke përfshirë ndërtimin e objekteve të reja dhe rikonstruktimin masiv të atyre ekzistuese.

Ministria e Arsimit cakton standardet dhe, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Brendshme gjatë gjithë vitit do të monitorojnë dhe vlerësojnë zbatimin e standardeve dhe buxhetit për investim në fushën e arsimit parauniversitar.

3.2. Kujdesi shëndetësor parësor dhe kujdesi shëndetësor publik

Në përputhje me politikat e decentralizimit të sektorit të kujdesit parësor shëndetësor, mbrojtjes së shëndetit publik dhe ligjit të buxhetit, njësitë e qeverisjes vendore janë përgjegjëse për zbatimin e granteve të kushtëzuara për këta objektiva të kujdesit shëndetësor.

3.3. Kujdesi social dhe reduktimi i varfërisë

Në zhvillimet e fundit dhe amendamentet e reja ligjore ka një zhvendosje graduale nga njohja e të drejtave të fëmijëve drejt respektimit dhe mbrojtjes së tyre. Një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet përfshirjes sociale të fëmijëve si një grup i dobët, ku politikat e shkuara sociale nuk ishin të drejtuara drejt përfshirjes së fëmijëve të përjashtuar.

Janë procese nën progres, si: licencimi i siguruesve të shërbimeve publike, transferimi i institucioneve rezidenciale në njësitë e qeverisjes vendore dhe zhvendosje e mëtejshme nga institucionet rezidenciale në shërbimet familjare. Për sa i përket arsimit dhe kujdesit shëndetësor, autoriteteve vendore u janë dhënë disa liri veprimi për funksionimin dhe mirëmbajtjen e objekteve (p.sh., ndërtesat e shkollave, klinikat, laboratorët), por nuk kanë fuqi vendimmarrëse për personelin dhe investimet. Ajo çfarë është e qartë është se arsimi universitar dhe sistemi i sigurimit shëndetësor, për shkak të ekonomive të shkallës dhe eksternaliteteve, janë mbajtur si funksione ekskluzive shtetërore. Mbrojtja sociale dhe zbutja e varfërisë, edhe pse me ligj janë të përcaktuara si funksione “të përbashkëta”, në praktikë funksionojnë si funksione të pastra të deleguara, për të cilat qeveritë vendore nuk kanë liri veprimi dhe funksionojnë si agjenci të thjeshta shpërndarjeje shërbimi dhe që financohen, udhëhiqen dhe vendosen tërësisht nga qeveria qendrore. Si agjentë, qeveritë vendore janë kujdesur vetëm për listën e përfituesve (me miratimin e qeverisë qendrore), kanë shpërndarë pagesat e vendosura dhe të financuara nga pushteti qendror dhe kanë raportuar në qeverinë qendrore lidhur me pagesat e kryera sipas listës së përfituesve. Prandaj, që kur funksionet e “mbrojtjes sociale dhe zbutjes së varfërisë” në Shqipëri kuptohen si zonë përfituese kombëtare, ato duhet të ricilësohen si funksione të deleguara të shtetit.

4. STRUKTURAT PËRGJEGJËSE

Në Strategjinë Kombëtare për Fëmijët theksohet themelimi i njësisve për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në nivel lokal. Në kuadrin e bashkëpunimit midis pushtetit vendor dhe dhuruesve të ndryshëm, janë themeluar disa struktura në disa rajone dhe bashki me qëllim krijimin e një rrjeti kombëtar për mbrojtjen e fëmijëve. Është vërejtur se legjislacioni ekzistues duhet të kompletohet me ligje dhe rregullore të reja, të cilat lehtësojnë dhe koordinojnë funksionet e këtyre njësisve dhe bashkëpunimin e tyre me qeverinë qendrore.


Disa nga këto struktura janë në 8 rajone (Elbasan, Vlorë, Kukës, Korçë, Shkodër, Tiranë, Durrës, Dibër) dhe në 9 bashki (Elbasan, Tiranë, Pogradec, Korçë, Fier, Gjirokastrë, Kukës, Kuçovë, Durrës). Këto struktura të reja janë miratuar nga këshilli rajonal/bashkiak dhe Organizatat Joqeveritare dhe mbështeten nga UNICEF-i, USAID-i dhe disa Organizata Joqeveritare (fondacioni Terre des Hommes, Save the Children, World Vision, Partners for Children etj.).

Ndërkohë ka pasur përpjekje dhe progrese në përgatitjen dhe diskutimin e manualit për procedurat që duhen ndjekur në njësitë bashkiake për mbrojtjen e fëmijëve. Ky manual përbëhet nga kapituj të ndryshëm të lidhur me përshkrimin e punëve të punonjësve civil për mbrojtjen e fëmijëve, identifikimin dhe menaxhimin e rasteve problematike, vlerësimin e situatës nëpërmjet përcaktimit të nivelit të riskut dhe përcaktimit të aktiviteteve për mbrojtjen e fëmijëve.

4.1 Shpërndarja e buxhetit në bashkitë

Pavarësisht përpjekjeve të fundit për ndikimin në procesin e decentralizimit në Shqipëri, me zbatimin e një formule të re transfertë/grant (duke përfshirë faktorin e barazisë) dhe caktimin e burimeve të reja të të ardhurave të veta, niveli i shpenzimeve për frymë në qeveritë vendore është ende i ulët dhe shpërndahet në mënyrë të pabarabartë midis bashkive dhe komunave.

Figura 2: Buxheti vendor, 2007-2009



Siç tregohet nga grafiku i mësipërm (figura 2), në fillim, fondet që vinin nga të ardhurat e veta të qeverive vendore (taksat dhe tarifat) ishin më të ulëta se fondet e transferuara nga qeveria qendrore, më pas ua kalonin transfertat dhe në vitin 2009 ishin pothuajse të barabarta. Kjo luhet në tendencën e fondeve reflekton edhe një herë paqëndrueshmërinë në kapacitetet e njësive të qeverive vendore për mbledhjen e të ardhurave të veta, që i atribuohet pabarazive në kapacitetin e të ardhurave në njësitë e qeverive vendore. Kjo pjesë duhet të jetë më e madhe në mënyrë që të shmanget varësia ndaj fondeve të qeverisë qendrore edhe pse në transfertat e pakushtëzuara.

4.2 Funkcionet e përbashkëta

Bashkitë (ashtu si edhe komunat) kanë këto funksione të përbashkëta për fushat e mëposhtme:

- a) arsimit i detyruar dhe i mesëm;
- b) sistemi i kujdesit parësor shëndetësor dhe mbrojtja e shëndetit publik;
- c) kujdesi social, reduktimi i varfërisë dhe garantimi i funksionalitetit të institucioneve përkatëse;
- d) rendi publik dhe siguria civile;
- e) mbrojtja e mjedisit;
- f) funksione të tjera të përbashkëta të përcaktuara me ligj.

Probleme të përbashkëta janë vërejtur në zona të ndryshme, por më të shumtat janë të lidhura me trajtimin e veçantë të fëmijëve me aftësi të kufizuara, përmirësimi i kushteve në shkolla, shpërndarja jo e duhur e ndihmave ekonomike nga bashkitë, ekzekutimi jo në kohë i vendimeve të gjykatave për detyrimin e mbajtjes nga prindërit, vendosja e jetimëve në qendrat rezidenciale, përmirësimi i kushteve të strehimit etj..

4.2.1 Arsimit – Vrojtim

Bashkitë/Komunat kanë përgjegjësi të kufizuara për shpërndarjen e shërbimeve të arsimit. Sipas marrëveshjeve aktuale, ato janë përgjegjëse për sigurimin e mirëmbajtjes dhe funksionimit të shkollave të arsimit bazë dhe shkollave të mesme. Aktualisht, financimi i shpenzimeve për mirëmbajtje dhe funksionim sigurohet nga Ministria e Financave nëpërmjet bllok granteve të pakushtëzuara në çdo bashki.

Qeveritë vendore kontribuojnë për shkollat me buxhetet e tyre të përgjithshme. Megjithatë, pasi ato marrin burime pa udhëzime përdorimi për to, shpenzimi për arsim nëpër bashki dhe komuna, ndryshon shumë. Në mënyrë të ngjashme, ndërsa fondet për pagat sigurohen gjithmonë nga buxheti i arsimit, fondet për pajisje dhe materiale, për mirëmbajtje dhe për trajnimin e mësuesve janë ndër të parat që shkurtohen kur lind nevoja e zvogëlimit të buxhetit të arsimit. Kështu që pajisjet, materialet, funksionimet, mirëmbajtja dhe trajnimi i mësuesve janë të keq-financuara.

Ky financim i ulët për qëllime mirëmbajtjeje ka ndikuar negativisht duke përkeqësuar cilësinë në arsimin bazë dhe atë të mesëm, sidomos në zona rurale dhe të varfra. Kjo reflektohet në normat negative të regjistrimit në shkollë të nxënësve në këto zona të veçanta.

4.2.2. Shëndetësia – Vrojtim

Duke u bazuar në Konventën e të Drejtave të Fëmijëve lidhur me çështjen e shëndetësisë, çdo fëmijë ka të drejtën e pamohueshme të jetojë. Shteti dhe të gjitha institucionet e tij duhet të marrin të gjitha masat që të sigurojnë mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijëve. Të gjithë fëmijët duhet të përfitojnë nga shërbimet për trajtimin e sëmundjeve dhe të shërbimit shëndetësor.

4.2.3. Ndhimja sociale – Vrojtim

Ndhimja sociale përfshin kryesisht shërbimet sociale dhe ndihmën ekonomike për njerëzit dhe grupet në nevojë, të paaftë të sigurojnë nevojat jetësore ose të zhvillojnë aftësi personale apo të mbështesin integrimin e tyre, si rezultat i kufizimeve ekonomike, fizike, psikologjike dhe sociale, ku një nga grupet e përfituesve janë fëmijët.

Sipas kuadrit të Strategjisë për të Drejtat e Fëmijëve, shteti ka detyrimin t'u sigurojë fëmijëve kushtet e përshtatshme për arsimim, formim profesional, shërbim të kujdesit shëndetësor, përgatitje për punësim dhe të krijojë mundësi në favor apo interes të fëmijëve që të arrijnë një integrim social sa më të kompletuar dhe zhvillim individual duke përfshirë zhvillimin e tij/saj kulturor ose shpirtëror.

Në mënyrë që t'u përgjigjen nevojave sociale në rritje, është e rëndësishme të rriten jo vetëm përgjegjësitë e njëjësive të qeverisjes vendore, por edhe të të gjithë komunitetit duke pasur si qëllim përfshirjen e sa më shumë aktorëve dhe përfitimin e shërbimeve sociale prej sa më shumë burimeve. Shërbimet kryesore të përfshira nën kuadrin e ndihmës sociale në nivelin e qeverisjes vendore janë:

- Sigurimi i familjeve me pamjaftueshmëri të të ardhurave me ndihma ekonomike – ky grup ka vëmendje të veçantë për pjesën e fëmijëve që janë shpëtuar nga rrjetet e trafikimit, që nuk marrin arsimin e përshtatshëm dhe si rrjedhojë lypin në rrugë.
- Sigurimi i shërbimeve për kategoritë në nevojë, duke iu referuar organizatave dhe qendrave, të cilat ofrojnë shërbime për familjet dhe fëmijët nën kujdestari.
- Lehtësimi i përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe integrimi i tyre në çerdhe dhe kopshte.

4.3 STRUKTURA LIGJORE PËR FËMIJËT DHE SEKTORËT PËRKATËS

Ratifikimi i Konventës për të Drejtat e Njeriut më 27 shkurt 1992 nga Qeveria dhe miratimi i dokumenteve të lidhura me këtë çështje konsiston në hapin e parë për thellimin e reformës së politikave sociale për të krijuar një mjedis të mbrojtur për fëmijët. Mjedisi nënkupton familjen, institucionet dhe shoqërinë që rrethon fëmijët. Sipas Konventës vendet anëtare kanë përgjegjësinë të përcaktojnë burimet dhe të identifikojnë edhe nevojat për të zhvilluar strategjitë për forcimin e këtyre mjediseve duke u përqendruar në respektimin dhe zbatimin e të drejtave të fëmijëve. I gjithë progresi i bërë deri tani është i mirëpritur dhe i inkurajuar për progresin e pajtimit të procesit të kuadrit ligjor ekzistues me Konventën dhe legjislacionin e BE-së për të fuqizuar zbatimin e ligjit. Niveli i njohjes së të drejtave të fëmijëve në Shqipëri është ende i ulët krahasuar me vendet e ngjashme.

Në 31 maj 2005, Këshilli i Ministrave miratoi Strategjinë Kombëtare të Fëmijëve dhe Planin Veprues për periudhën kohore 2005-2010 me VKM nr. 368, datë 31.05.2005. Këto dy dokumente shprehin objektivat strategjike të qeverisë së Shqipërisë dhe në të njëjtën kohë

angazhimin e vendit tonë në përmbushjen e detyrimeve që vijnë nga Konventa e të Drejtave të Fëmijëve. Legjislacioni që mbron të drejtat e fëmijëve nuk është i integruar, por i ndërtuar mbi politikat sektoriale (për arsim, shëndetësi, mbrojtje sociale) dhe jo në bazë të të drejtave, si arsimim, shëndetësi, mbrojtje sociale etj. Një legjislacion i tillë nuk ndikon në reduktimin e përjashtimit, por parashikon përfitimet nga shërbimet e përfshira. Në anën tjetër, mungesa e koordinimit midis institucioneve rrit vështirësitë në identifikimin e fenomenit, vetëdijes lidhur me dimensionet, analizon shkaqet dhe vonon në planifikimin e ndërhyrjeve efektive në politikat për mbrojtje sociale, zhvillim dhe ri-integrimin e fëmijëve.

Në 4 Nëntor 2010, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin Nr. 10347 “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës”. Sipas nenit 38 të këtij ligji, pika 1, në këshillin e qarkut, krijohet Njësia për të Drejtat e fëmijës si si njësi e posaçme ose si njësi e strukturave të ngarkuara me çështje sociale. Detyrat e njësisë janë:

- a) të monitorojë dhe të vlerësojë mënyrën e zbatimit të ligjeve dhe të politikave që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës në territorin e qarkut;
- b) të identifikojë dhe të koordinojë referimin e rasteve të shkeljeve apo të abuzimit, të keqpërdorimit të të drejtave të fëmijëve në territorin e qarkut;
- c) të koordinojë funksionimin e grupit multidisiplinar, për identifikimin, analizën dhe referimin e rasteve të dhunës në familje në territorin e qarkut;
- d) të bashkëpunojë dhe të shkëmbejë informacionin për trajtimin e të drejtave të fëmijës me çdo strukturë përgjegjëse shëndetësore, arsimore, policore, të qeverisjes vendore, në bashki dhe komuna, apo të shoqërisë civile;
- e) të organizojë takime informuese, edukuese dhe trajnuese për të drejtat e fëmijës në qark;
- f) t’i raportojë këshillit të qarkut për ecurinë e respektimit të të drejtave të fëmijës në territorin e qarkut;
- g) t’i raportojë periodikisht Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës të dhënat statistikore që ka përpunuar, për gjendjen e të drejtave të fëmijës në qark;
- h) t’i paraqesë periodikisht Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës informacione për situatën e zbatimit të të drejtave të fëmijës në qark.

Në zbatim të të njëjtit ligj, neni 38 pika 2, pranë këshillit të qarkut krijohen grupet multidisiplinare për mbrojtjen, referimin dhe analizën e rasteve të fëmijëve në rrezik në territorin e qarkut.

4.3.1 Arsimi

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë është e përcaktuar se çdo individ ka të drejtën të arsimohet (neni 57). Duke folur në terma më konkretë, në ligjin për Arsimin Parauniversitar është përcaktuar barazia ndërmjet qytetarëve të Republikës së Shqipërisë për t’u arsimuar në çdo nivel, pavarësisht kategorisë sociale, kombësisë, gjuhës, fesë, gjinisë apo bindjeve politike. Ligji përcakton detyrimin për arsimimin e fëmijëve të grupmoshës 6-16 vjeç për të ndjekur arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar. Ligji përcakton qartë së prindërit duhet t’i çojnë fëmijët e tyre në shkolla publike ose private për të kryer arsimin e detyrueshëm.

Për më tepër në ligj ka parashikime për situatat kur prindërit nuk i çojnë fëmijët e moshës 6-16 vjeç në shkollë, ose kur fëmijët nuk e frekuentojnë shkollën pa një justifikim të arsyeshëm, ose kur fëmijët braktisin shkollën, atëherë prindërit duhet të paguajnë dënimet për kundërvajtje administrative. Vendimi për dënimin jepet nga kryetari i bashkisë ose komunës sipas propozimit të drejtorit të shkollës. Të bazuara në parakushtet e caktuara nga ligji për Arsimin Parauniversitar

dhe objektivat në dokumentet strategjike, fokusi kryesor i Bashkive/Komunave është:

- Rritja e cilësisë së arsimit të fëmijëve.
- Sigurimi i mbështetjes emocionale dhe zhvillimit social.
- Krijimi dhe menaxhimi i qendrave kulturore dhe sociale që zhvillojnë standardet arsimore duke garantuar mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

4.3.2 Ndhimja ekonomike

Në kuadrin e ligjit të ri “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” dhe Strategjisë për Shërbime Shoqërore parashikohet realizimi i një reforme të plotë që ka për qëllim reduktimin e varfërisë dhe krijimin e një sistemi cilësor për shërbime shoqërore për grupe dhe individë në nevojë, veçanërisht për fëmijët. Një vend të rëndësishëm për zbatimin e kësaj reforme zë decentralizimi i shërbimeve dhe zgjerimi i kompetencave të qeverisjes vendore në administrimin përkatës, si edhe ndryshimi i roleve në strukturat e nivelit vendor dhe atij qendror, si edhe në organizatat civile për krijimin dhe zbatimin e politikave, të cilat kanë në fokus interesat e fëmijëve, de-institucionalizimin e shërbimeve shoqërore dhe krijimin e shërbimeve të reja alternative.

Në kuadrin e decentralizimit, shërbimet shoqërore dhe institucionet përkatëse po transferohen nën përgjegjësinë e qeverisjes vendore. Në këtë mënyrë, shërbimet për fëmijët po transferohen nga shërbimet në institucione, në shërbimet në familje, në komunitet ose në struktura të njohura si familjet shoqërore. Ky moment është shumë i rëndësishëm në përmirësimin e efikasitetit, cilësisë dhe sasisë së shërbimeve dhe afrimit të tyre afër kërkesave dhe nevojave të komunitetit.

4.4 VLERËSIMI I BASHKIVE NËN DREJTIMIN E PËRBASHKËT LIDHUR ME SHPËRNDARJEN E BUXHETIT PËR FËMIJËT DHE SIGURIMIN E SHËRBIMEVE

Kjo pjesë e studimit është përqendruar më shumë në detajet e Rishikimit të Shpenzimeve Publike në bashkitë me drejtim të përbashkët për buxhetin e shpenzuar për fëmijët nga sektorë të veçantë. Meqenëse nuk ka llogaritje të veçantë për buxhetin e shpenzuar drejtpërdrejtë për fëmijët në nivelin e bashkive (edhe në nivel qendror) fillimisht do të analizojmë atë pjesë të buxhetit qendror, që sipas institucioneve të ndryshme, shpërndahet për fëmijët, si:

- Ministria e Arsimit – Arsimi “Bazë” dhe “i Mesëm” që ndiqet nga fëmijët e moshave 7-18 vjeç.
- Ministria e Shëndetësisë – “Kujdesi Shëndetësor Parësor” dhe “Kujdesi Shëndetësor Dytësor”, edhe pse disa pjesë të këtij të fundit është transferuar nga Instituti i Shëndetit Publik që shpërndan fondet e bazuara në performancën e institucioneve të kujdesit shëndetësor parësor.
- Ministria e Punës, Çështjeve Shoqërore dhe Shanseve të Barabarta – “Mbrojtje Shoqërore” dhe “Shanse të Barabarta”.

Kategoritë kryesore të fondeve në bashkitë janë:

- 1) Të ardhurat nga taksat dhe tatimet
- 2) Transfertat e pakushtëzuara (grantet)

- 3) Transfertat e kushtëzuara nga pushteti qendror
- 4) Grantet konkurruese

Kategoritë kryesore për shpenzimet janë:

- 1) Shpenzimet për funksionet e veta (ekskluzive): në këtë term përfshihen shpenzimet për administrim, shërbimet publike (ndriçimi, gjelbërimi etj.), institucionet vendore të sportit dhe kulturës, mirëmbajtja e rrugëve dhe transporti lokal.
- 2) Shpenzimet për funksionet e deleguara: në këtë pjesë përfshihen shpenzimet për mbrojtje shoqërore dhe kujdes shoqëror.
- 3) Shpenzimet për funksionet e përbashkëta: në këtë pjesë përfshihen shpenzimet për mirëmbajtjen dhe funksionimin e arsimit parauniversitar, konviktet dhe investimet në këtë fushë.
- 4) Shpenzimet për zhvillim rajonal: në këtë term përfshihen shpenzimet për infrastrukturën vendore, arsimim etj.

Analiza jonë do të bazohet në kontrollimin e këtyre fondeve në mënyrë që të vëmë në dukje shpërndarjen e buxhetit për fëmijët dhe për shërbimet publike të financuara nga këto fonde.

4.5 VROJTIM I PËRBASHKËT PËR DY BASHKI



4.5.1 Arsimimi



Ndërkohë që analizojmë zhvillimin e arsimit në dy bashki, vërehet se gjatë fazave të tranzicionit të dyja kanë kaluar ulje-ngritje në arsim sidomos në atë bazë dhe të mesëm. Për shkak të migrimit nga zonat rurale në ato urbane shkollat nëpër qytete nuk ishin të përgatitura të përballonin këtë fluks.

Nuk kishte një infrastrukturë të përshtatshme dhe kjo u reflektua në rritjen e numrit të nxënësve për klasë, që ishte më i lartë se niveli i pranuar. Shumë laboratorë dhe biblioteka u transformuan në klasa duke ndikuar negativisht në cilësinë e arsimit.

Ndërkohë që numri i nxënësve u rrit, e kundërta u reflektua në numrin e mësuesve, ku shumë prej tyre ose emigruan jashtë vendit ose u zhvendosën në sektorë të tjerë të ekonomisë për kushte më të mira pune.

4.5.2 Shëndetësia



Një çështje e një rëndësie vendimtare është e lidhur me mënyrën e të ushqyerit të fëmijëve të moshës 0-12 muaj. Shumë nëna të reja për shkak të ngarkesës në punë dhe rikthimit sa më shpejt në vendet e punës, zëvendësojnë ushqimin me qumështin e tyre me produkte të gatshme, të cilat nuk janë të rekomandueshme. Kjo shihet veçanërisht në kategoritë e klasës së mesme dhe kundërshtohet nga standardet ndërkombëtare dhe organizatat ndërkombëtarë, të cilët rekomandojnë zgjatjen e periudhës të të ushqyerit me qumështin e nënës të paktën deri në 6 muaj.

Mjedisi është gjithashtu një shqetësim i konsiderueshëm për shkak të ndikimit të rëndësishëm që ka në rritjen e shëndetshme të fëmijëve. Fëmijët janë të ekspozuar ndaj disa faktorëve të mjedisit, si: ndotja e ujit, plehrat, vendet dhe produktet e ndotura, kushtet jo të shëndetshme të jetesës, transporti jo i sigurt etj. Të dyja bashkitë i kanë përfshirë këto çështje në planet e tyre për zhvillim strategjik, por masat e marra për sigurimin e një mjedisi të shëndetshëm duhet gjithashtu të mbështeten nga buxheti dhe aktivitete konkrete.



Hapa progresivë janë bërë në këtë drejtim sidomos në bashkinë e Korçës, pasi ka tradita të vjetra në mbrojtjen dhe mbajtjen pastër të mjedisit rrethues, por duhet të bëhet ende një punë shumë e madhe për të rritur vetëdijen e komunitetit dhe qeverisë vendore për të bashkëpunuar për një mjedis më të sigurt dhe të mbrojtur sipas standardeve ndërkombëtare.

4.5.3 Ndiqja dhe mbrojtja shoqërore



Dy qytetet nën vëzhgim, ashtu si i gjithë vendi, kanë vuajtur nga efekte negative të njëjta të periudhës së tranzicionit. Këto efekte reflektohen në fusha të ndryshme të jetës së komunitetit, veçanërisht në atë të grupeve më të dobëta, si: fëmijët, njerëzit e moshuar, minoritetet, njerëzit më aftësi të kufizuara etj.

Një problem i përbashkët, që krijon vështirësi të mëtejshme, ndërkohë që analizojmë të dhënat për buxhetin e shpërndarë për fëmijët, është mungesa e informacioneve të sakta lidhur me numrin e fëmijëve. Për shkak të normave të larta të migrimit joformal nga zonat rurale në ato urbane, shumë procedura lidhur me regjistrimin e lindjeve janë lënë pas dore edhe pse ky është një detyrim ligjor. Sipas ligjit nr. 8950, datë 10.10.2002 “Për Regjistrimin Civil”, prindërit janë të detyruar me ligj të regjistrojnë fëmijën e tyre brenda 45 ditëve pas lindjes duke i dhënë fëmijës emrin dhe mbiemrin. Shkelja e këtij ligji krijon probleme në identifikimin e saktë të fëmijëve që duhet të ndjekin shkollën dhe të marrin përfitimet nga shërbime të tjera. Ky problem është

më i dukshëm në familjet e varfra ose që i përkasin komunitetit rom. Në përgjithësi ka mungesë të procedurave të përshtatshme që zbatohen për grupet e fëmijëve në terma të përfitimeve dhe kujdesit ditor të përshtatshëm nga qendra të cilat përmbushin nevojat e tyre.

► VLERËSIM E PËRFUNDIMTARE

Të drejtat e fëmijëve në Shqipëri, pas ratifikimit të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, po bëhen gjithnjë e më shumë pjesë e axhendës në zhvillimin e politikave kombëtare dhe kuadrit ligjor e institucional. Ndryshime të thella kanë ndodhur në mënyrën e perceptimit të të drejtave të fëmijëve, si nga qeveria ashtu edhe nga shoqëria. Përgjegjësitë e institucioneve, familjes dhe komuniteteve në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve janë rritur. Analizat e politikave, buxheteve dhe shpërndarjes së përgjegjësiwe institucionale, të paraqitura në këtë raport, dëshmojnë progresin gradual drejt realizimit të të drejtave të të gjithë fëmijëve në Shqipëri. Megjithatë, pavarësisht nga arritjet, raporti tërheq vëmendjen mbi çështje që ndikojnë në realizimin e të drejtave të fëmijëve, e për pasojë duhet të analizohen me përgjegjësi nga hartuesit e politikave.

Qeveria shqiptare vazhdimisht ka treguar përkushtimin e saj në drejtim të përmirësimit të mirëqënies së fëmijëve. Ligji nr. 10347, “Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve” është miratuar nga parlamenti shqiptar më 4 Nëntor, 2010. Në zbatim të këtij ligji, është krijuar Agjensia Kombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, Kjo arritje përfaqëson nivelin më të lartë të përgjegjësisë të marrë ndonjëherë nga qeveria shqiptare post-komuniste. I kombinuar edhe me politikat e decentralizimit, ajo krijon premisat për ndryshime në prioritetet dhe aktivitetet.

Reduktimi i varfërisë dhe pabarazisë është një objektivi që duhet dhe mund të arrihet në çdo vend. Çdo shoqëri që ka fëmijë të mirë-ushqyer, të strehuar, të mbrojtur, të edukuar, të shëndetshëm dhe të zhvilluar, është një shoqëri që mbron të tashmen dhe investon për të ardhmen, sepse ky përjashtim i dyfishtë i këtyre kostove, kthehet në një përfitim të dyfishtë për të gjithë shoqërinë.

Strategjia Ndërsektoriale e Përfshirjes Sociale, si një komponent i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), synon të ndikojë në uljen e varfërisë dhe përjashtimit të fëmijëve. Kjo strategji, si një përmbledhje e strategjive të Mbrojtjes Sociale, Punësimit, Arsimit, Shëndetësisë etj formulon objektiva të rëndësishme në lidhje me politikat që ndikojnë në rritjen e mirëqënies së fëmijëve. Në këtë strategji një vëmendje e veçantë i është kushtuar çështjeve të fëmijëve veçanërisht kategorive të fëmijëve që janë të përjashtuar ose në rrezik përjashtimi.

Raporti “Politikat e përfshirjes sociale për fëmijët dhe financimi i tyre në Shqipëri”, në përputhje me mënyrën e organizimit të informacionit, trajton disa çështje të rëndësishme të veçantë, të grupuara si vijon:

Në pjesën e parë, që i kushtohet analizës së politikave të përfshirjes sociale për fëmijët, raporti nënvizon se:

Përmirësimi i mbledhjes së të dhënave është i rëndësishëm për krijimin e një sistemi që mundëson analizën e informacionit në përputhje me treguesit botërorë të vlerësimit të realizimit të të drejtave të fëmijëve. Vetëm në këtë mënyrë do të mund të vlerësohet përjashtimi shoqëror i fëmijëve, duke mundësuar hartimin e politikave gjithëpërfshirëse sociale.

Politikat sociale që kanë të bëjnë me realizimin e drejtave të fëmijëve duhet të harmonizohen dhe integrohen. Duhet të integrohet në sistemin e kujdesit shëndetësor parësor sigurimi i shërbimeve për mirëritjen dhe ushqimin e fëmijës dhe nënës në mënyrë që të parandalohet keq-ushqyerja dhe sëmundjet. Gjithashtu aksesit dhe cilësia e shërbimeve për nënat dhe fëmijët duhet të përfshihet në të gjitha nivelet, veçanërisht në zonat rurale.

Sistemi i sotëm i ndihmës ekonomike siguron vetëm përfitime “ekonomike” por jo “sociale”. Pjesa më e madhe e përfituesve të ndihmës ekonomike kanë një ose më shumë fëmijë (92%); Mirëqënia e fëmijëve nuk ndryshon për ata që marrin ndihmë ekonomike (arsimimi, kujdesi shëndetësor, kushte banimi më të mira); Shumë – dimensionaliteti i varfërisë nuk është marrë në konsideratë (dhe veçanërisht varfëria e fëmijëve) nuk merret në konsideratë nga skema aktuale e ndihmës ekonomike.

Në pjesën e dytë, që i kushtohet analizës së kostove të politikave sociale për fëmijë, raporti tërheq vëmendjen për:

Planifikimin e burimeve financiare, i cili për politikat shoqërore të mbrojtjes së grupeve të dobëta të fëmijëve duhet të bazohet mbi analizën e nevojave. Burimet financiare duhet të garantohen jo vetëm në nivelin e qeverisjes qendrore, por edhe në atë rajonale dhe vendore. Planifikimi i fondeve duhet të mbështetet në tregues të matshëm. Standardet duhet të zhvillohen për shërbime të veçanta të ofruara në mënyrë që monitorimi dhe supervizimi të jetë mbi bazën kohore.

Shpërndarja e fondeve nga buxheti qendror në buxhetin vendor duhet të synojë në zvogëlimin e pabarazive. Duhet të përfshihen më shumë faktorë në formulat e shpërndarjes së fondeve në mënyrë që mos të ndëshkohen bashkitë me burime të kufizuara ekonomike. Qëllimi kryesor është përmirësimi i efektivitetit, parashikueshmërisë, drejtësisë në shpërndarjen e fondeve midis njësive të qeverive vendore, transparencës dhe përgjegjësisë. Ngjashmërisht, kjo mund të mundësojë një ndarje të mundshme të bazës së përbashkët të ardhurave fiskale nga taksat e të ardhurave dhe të fitimit midis qeverive vendore dhe asaj qendrore. Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe ndërtimi i kapaciteteve për auditim të brendshëm dhe të jashtëm duhet të shihet gjithashtu si kusht parësor për një ndërveprim dinamik midis niveleve të ndryshme të qeverisë.

Pjesa e tretë që i kushtohet analizës së buxheteve vendore si mekanizëm i përfshirjes sociale të fëmijëve, nënvizon:

Domosdoshmërinë e forcimit institucional të bashkive dhe komunave, që përfshin përmirësimin e strukturave administrative; qartësimin dhe specifikimin e lidhjeve midis këshillave, kryetarit dhe administratave korrespondente; thjeshtëzimin dhe transparencën në strukturat korrespondente; rritjen e cilësisë së punonjësve të qeverive vendore përmes zgjerimit të mbulimit të ligjit të shërbimit civil, duke përfshirë dhe ato të administratave të komunës.

Forcimin e strukturave administrative përgjegjëse për monitorimin dhe raportimin e realizimit të të drejtave të fëmijëve. Në të njëjtën kohë, duhet siguruar bashkëpunimi ndër-institucional në nivel qendror, rajonal dhe vendor që është i nevojshëm për zbatimin e politikave shoqërore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

► REKOMANDIME

Politikat sociale në fushën e të drejtave të fëmijëve, shpesh u adresohen problemeve më akute të krijuara nga mungesa e hapësirave ligjore. Këto ndryshime janë të domosdoshme dhe plotësojnë kuadrin ligjor për fëmijët. Ky kuadër në Shqipëri përfshin një kornizë ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare. Është e dëshirueshme që këto politika dhe inisiativa legjislative të plotësohen dhe të kenë një karakter afatgjatë parashikues. Vlen të theksohet që përfshirja e fëmijëve në klauzola të ligjeve ose akteve nënligjore të tjera të veçanta është një tregues për “përfshirjen” e të drejtave të fëmijëve në legjislacionin kombëtar. Ligje dhe politika sociale që u adresohen posaçërisht fëmijëve karakterizohen nga parimet bazë të KDF dhe sidomos nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës.

Në politikat sociale ka zhvillime pozitive si p.sh baza ligjore për shërbimet alternative dhe dokumentet përkatëse. Dokumenti Strategjik i Kujdestarisë dhe dokumenti plotësues “Strategjia kombëtare për luftën kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve, viktimat të trafikimit” janë shembuj të një politike me karakter parashikues progresiv. Politikat në fushën sociale duhen konsideruar në vazhden e procesit të decentralizimit, ndikimi i të cilave në veçanti në fushën e shërbimeve sociale duhet ekzaminuar rast pas rasti për të parë influencën e tyre.

Institucionalizimi dhe infrastruktura në funksion të tij janë tërësisht të nevojshme në implementimin e politikave sociale për fëmijët, si në rastet kur kërkohen institucione të posaçme, ashtu dhe kur dispozitat për ta përfshihen brenda institucioneve të tjera dhe ku duhet të garantohet qëndrueshmëria e institucioneve dhe evoluimi i tyre sipas nevojave të fëmijëve. Kjo jo vetëm në insitucionalizimin ligjor dhe financimin e institucioneve por edhe në bashkërendimin e punës, pavarësisht nga niveli qendror, rajonal apo vendor.

Njëkohësisht, njohja dhe forcimi i strukturave të sapo krijuara siç janë Njësitë për Drejtat e Fëmijëve dhe Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe përfshirja e tyre në një sistem i cili do të garantojë evitimin e fragmerntarizimit është tregues qëndrueshmërie. Mekanizmat e referimit dhe të mbrojtjes duhet të trajtohen si pjesë e pandarë e implementimit të politikave. Kjo do të bëjë të mundur standartizimin e aktivitetit të tyre dhe do të ndikonte në njësimin e procedurave dhe protokolleve që ndiqen në veprimtarinë e tyre. Në të ardhmen detajimi nga ana ligjore e përgjegjësive do të jetë një ndihmë e vlefshme në angazhimin për këto përgjegjësi. Gjithashtu, varësia e përshtatshme dhe ndarja e kompetencave në përputhje me kapacitetet duhet të jetë në qendër të vëmendjes.

Hartimi i politikave nën kuadrin udhëzues të një strategjie të re kombëtare për fëmijët është domosdoshmëri për garantimin dhe realizimin e të gjithave të drejtave të tyre. Politikat kombëtare për mirëqenien e fëmijëve (politikat sociale, shëndetësore, edukimit, strehimit, etj.) duhet të synojnë promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Këto politika duhet t’u japin prioritet uljes së varfërisë dhe përjashtimit, pabarazisë, mbështetjes së familjes, të trajtojnë tolerancën dhe kohezionin social, të sigurojnë përfshirjen sociale dhe të nxisin bashkëpunimin e aktorëve të ndryshën në të gjitha nivelet e qeverisjes.

Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet mbrojtjes së grupeve të fëmijëve vulnerabël si: fëmijëve me aftësi të kufizuar, fëmijëve të braktisur, fëmijëve në institucionet rezidenciale, fëmijëve të minoriteteve, fëmijëve që punojnë apo jetojnë në rrugë, fëmijëve të pashoqëruar, fëmijëve që jetojnë në kushtë varfërie apo varfërie ekstreme, fëmijëve në konflikt me ligjin, etj. Politikat e adresuara për këto grupe, që tashmë kanë mundësi të bazohen në studime të realitetit tonë apo eksperiencat e vetë fëmijëve, duhet të jenë të afta të parandalojnë, zbulojnë dhe përgjigjen formave të ndryshme të dhunës apo përjashtimit të fëmijëve.

Megjithë rëndësinë që ka miratimi i ligjit 10347 datë 04.11.2010, përmirësimet e kuadrit ligjor duhet të vazhdojnë dhe të thellohen. Rritja e përgjegjësive të shtetit dhe shoqërisë shqiptare ndaj të drejtave të fëmijëve kërkon planifikimin e ndërhyrjeve strategjike në drejtim të:

- 1) Thellimit të decentralizimi dhe përdorimit të hapësirave të tij në funksion të hartimit të politikave rajonale të mirëqënies së fëmijëve. I harmonizuar me decentralizimi financiar, ky proces do të rrisë mundësitë reale të pushtetit vendor për hartim dhe zbatim të politikave rajonale;
- 2) Zhvillimit të zyrave për të drejtat e fëmijëve në qark, si një mekanizëm ndihmues për rritjen e efektivitetit të politikave publike të mirëqënies së fëmijëve;
- 3) Shndërrimit të objektivave të mirëqënies së fëmijëve në komponentë thelbësorë të strategjive rajonale të zhvillimit;

Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet përfaqësuesve të pushtetit legjislativ në nivel qendror dhe atyre legjislativ në nivel vendor është faktor thelbësor në fuqizimin e institucioneve që vëzhgojnë dhe koordinojnë politikat publike të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Ky proces duhet të shoqërohet me përfshirjen e të drejtave të fëmijëve në politikat dhe strategjitë rajonale, duke siguruar edhe financimet përkatëse. Megjithatë, është shumë e rëndësishme të kuptohet nga të gjithë se përpjekjet e hartuesve të politikave, zbatuesve të politikave, të shoqërisë civile, të qytetarëve dhe vetë fëmijëve duhen të harmonizohen, koordinohen dhe plotësojnë njera tjetrën sepse “çështja e mirëqënies së fëmijëve është çështje e të gjithë shoqërisë”.

► BIBLIOGRAFI

- 1) Aleanca për Fëmijët në Shqipëri “*Raporti i Monitorimit të Strategjisë Kombëtare të Fëmijëve dhe Planit Kombëtar të Veprimit 2005-2011*”, Tiranë, 2006
- 2) Avokati i Popullit, OSBE, (Shtator 2003) Strategjia Kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom
- 3) ETF Report, “Migration patterns and human resources development issues in Albania”, (January 2008),
- 4) Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e PAK, (ADRIF), (Dhjetor 2008), “Studim i kuadrit ligjor mbi vlerësimin dhe Komisionimin e AK në Shqipëri (versioni Draft)
- 5) Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, (Qershor 2008), “Hapat e vegjël-Vlerësim formativ i zbatimit të Standardeve të Shërbimeve Shoqërore për personat me aftësi të Kufizuara në Qendrat rezidenciale dhe ditore, si dhe mbrojtja dhe zbatimi i të drejtave të PAK,
- 6) Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e PAK, (ADRIF), (Dhjetor 2006), Raport vëzhgimi – Respektimi i të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara
- 7) Fondacioni i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë – SOROS, “Raport i Monitorimit të Shqipërisë në Procesin e Stabilizim Asociimit (1 Tetor 2007-15 Tetor 2008)
- 8) INSTAT, (Prill 2009), Shqipëria: Trendi i Varfërisë 2002 - 2005-2008
- 9) INSTAT, ISHP, (Tetor 2009) Studimi Demografik Shëndetësor në Shqipëri
- 10) Institutit Shqiptar për Politikat Publike, (Dhjetor 2006), “Një sistem monitorimi për Strategjitë Rajonale”, fq. 39-41
- 11) Karaj Th, A. Tamo” *Dhuna ndaj Fëmijëve në Shqipëri*”, UNICEF, Tiranë, 2006
- 12) Komisioni Evropian, (2008), Progres Raport i Shqipërisë mbi Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit të Shqipërisë me BE,
- 13) Komisioni Evropian (2009), Progres Raport i Shqipërisë mbi Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit të Shqipërisë me BE
- 14) *Ministria e Drejtësisë (2008) Vjetari Statistikor*
- 15) Ministria e Shëndetësisë, (2008), Studimi Kombëtar “Prevalenca e çrregullimeve nga pamjaftueshmëria jodike të fëmijët dhe gratë shtatzëna”
- 16) Ministria e Shëndetësisë në Shqipërisë, (Prill 2004), “Strategjia Afatgjatë e zhvillimit të sistemit shëndetësor Shqiptar
- 17) Ministria e Punës, Çështjeve Shoqërore dhe Shanseve të Barabarta, Raport i Monitorimit të Zbatimit të strategjisë së fëmijëve, Tiranë, 2010.
- 18) Qendra Fëmijët Sot, (Qershor 2008), Fëmijët në Shqipëri
- 19) Qendra Fëmijët Sot, (2008) Higjiena në zonat rurale. Parandalimi i sëmundjeve infektive. F. 8-21.
- 20) Qendra për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, (Qershor 2007), “Kriminaliteti i të miturve në Shqipëri”
- 21) Qendra për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, “Drejtësia për të mitur në Shqipëri”

- 22) Qendra e Studimeve Humane, (2007), “Situata arsimore e fëmijëve romë në Shqipëri”
- 23) Save the Children, Education of Roma Children in Albania
- 24) Seda, UNDP, (Mars 2005), “raport i Zhvillimit Njerëzor për Shqipërinë – Politikat në dobi të grave dhe të varfërve në Shqipëri, Vënia në veprim e OZHM
- 25) Sekretariati Teknik i Fëmijëve pranë MPCSShB, (2008) “Raport për zbatimin e objektivave të strategjisë Kombëtare për Fëmijët Qershor 2007-Maj 2008
- 26) UNDP, 2008, Partnering for Development
- 27) UN, 2009, The Millennium Development Goals Report
- 28) World Bank (2006), Roma and Egyptians in Albania *From Social Exclusion to Social Inclusion, paper no 53*

Akte Normative (Kombëtare dhe Ndërkombëtare) dhe politika

- 1) Ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 28, viti 1998, faqe 1073
- 2) Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, ratifikuar me ligjin nr. 7531, datë 11.12.1991 “Për ratifikimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijëve”.
- 3) Marrëveshja e Stabilizim- Asociimit
- 4) Ligji nr. 8387, datë 30.07.1998 “Për disa ndryshime të Ligjit nr. 7952, datë 21.06.1995”
- 5) Ligji nr. 8950, datë 10.10.2002, “Për gjendjen Civile”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 71, viti 2002, faqe 1975.
- 6) Ligji nr. 9355 datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 22, viti 2005, faqe 829.
- 7) Ligji nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizmin dhe funksionimin e qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 25, viti 2000, faqe 1269.
- 8) Ligji nr. 3766 datë 17.12.1963 “Për kujdesin shëndetësor” (i ndryshuar), botuar në Fletoren Zyrtare nr. 16, viti 1963, Faqe 312.
- 9) Ligji nr. 9669 datë 18.12.2006 “Për masat e dhunës në marrëdhëniet familjare”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 150, viti 2006, faqe 6113.
- 10) Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 368, datë 31.05.2005, “Strategjia Kombëtare e Fëmijëve dhe Plani i Veprimit 2005-2010”
- 11) Vendimi Këshillit të Ministrave nr. 782, datë 16.1.2006, ”Strategjia Kombëtare e Rinisë dhe Plani i Veprimit 2007-2013”
- 12) Dispozitat Normative për Shkolla Publike
- 13) Strategjia Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik e Shoqëror
- 14) Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjes së Viktimave të Trafikimit
- 15) Strategjinë e Shërbimeve Shoqërore 2005-2010

- 16) Strategjia Kombëtare e Arsimit 2004 -2015 e MASH-it, miratuar në 2004
- 17) Strategjia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar 2009-2013 e MASH-it, miratuar në Korrik 2009
- 18) Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe kundër dhunës në Familje 2007- 2010 e MPCSSHB, (2007)
- 19) Strategjia Ndërsektoriale e Përfshirjes Shoqërore 2007-2013 e MPCSSHB, miratuar në 2 shkurt 2008
- 20) Strategjia Sektoriale e Mbrojtjes Shoqërore 2008-2012 e MPCSSHB, miratuar në Janar 2008
- 21) Draft-Strategjinë Kombëtare kundër Gjakmarrjes, përgatitur nga Komiteti i Pajtimit Mbarëkombëtar
- 22) Buxhetet e shtetit për vitet 2007, 2008, 2009 dhe plani 2010
- 23) Programi Buxhetor Afatmesëm 2007 – 2009
- 24) Programi Buxhetor Afatmesëm 2008 – 2010
- 25) De Soto, H. et. al. (2008). Poverty in Albania: A Qualitative Survey. Technical Paper No. 520. Europe and Central Asia Region Environmentally and Social Sustainable Development Series. Washington, D.C.: World Bank.
- 26) IMF. May 28, 2002. "Assessing Sustainability." The Policy Development and Review Department. May 28, 2002. Washington DC.
- 27) IMF. 2004. "Albania: Selected Issues in Tax Policy Design." A technical assistance report.
- 28) IMF. 2004. "Fiscal Adjustment in IMF-Supported Programs." Draft Issues Paper.
- 29) OECD (2007). Reviews of National Policies for Education: South Eastern Europe: Volume1: Albania, Bosnia-Herzegovina, Bulgaria, Croatia, Kosovo. Paris: OECD.
- 30) Palomba, G. and Vodopivec, M. (2004). Financing, Efficiency, and Equity in Albanian Education. Washington, DC: World Bank.
- 31) Raporte nga INSTAT-i.
- 32) Shqipëria Ristrukturimi i Shpenzimeve Publike për të Mbështetur Rritjen – Rishikim i Shpenzimeve Publike (vol 1 & 2), Banka Botërore 2006
- 33) Tibi, C. et. al. (2004). Public Expenditure Tracking Survey. Final Report Prepared for the Ministry of Education and Science.